

PREMTIMET ELEKTORALE

www.altax.al

NË

ZGJEDHJET POLITIKE 2009



ALTAX

POLIFAKT_{al}

www.polifakt.al

PREMTIMET ZGJEDHORE TË PD, 2009

PREMTIME FISKALE DHE BUXHETORE

Nr.	Premtimi elektoral
1	160 mijë të punësuar ¹ në mandatin e dytë (2009-2013)
2	Do nxjerrim nga varfëria 4 vitet e ardhshme edhe 300 mijë shqiptarë.
3	Trifishojmë investimet në zonat rurale
4	Nuk do ketë pension në fshatra nën 100 dollarë
5	Do të barazojmë pensionet e fshatit me pensionet e qytetit
6	Taksa e tabelës për bizneset do të përcaktohet me ligj dhe do të jetë vetëm 1 euro
7	Investimet e huaja në Shqipëri do të çojmë në 8 miliard euro
8	Për të nxitur punësimin në zonat e varfra heqim taksat për bizneset për 5 vjet ² .
9	Mandatin e ardhshëm asnjë shqiptar nën nivelin e 2 dollarëve në ditë
10	Do të ndërtojmë banesa sociale dhe do të zgjidhim përfundimisht problemin e 450 familjeve
11	Rrogat dhe pensionet do të jenë dy herë më të larta se sa gjashtë vende anëtare të BE

PREMTIME PËR SHËNDETËSINË

Nr.	Premtimi elektoral
1	Krijojmë partneritet publik-privat në shëndetësi
2	Luftojmë korrupsionin në sektorin e shëndetësisë
3	Shtrijmë sigurimet shëndetësore edhe në sektorin privat

PREMTIME PËR ARSIMIN DHE RININË

Nr.	Premtimi elektoral
1	Dyfishojmë buxhetin për sektorin e arsimit në 8% të PBB
2	2 mijë vende shtesë në universitetet publike
3	Bursë plus 100 mijë USD/vit për çdo të ri që fiton studimet në 1 nga 10 universitetet më të mira të planetit
4	Plani ynë është që asnjë fëmijë analfabet të mos jetë në Shqipëri
5	Çdo fëmijë që mbaron 9-vjeçaren të mund të vazhdojë gjimnazin
6	Hapje ndaj sektorit privat në arsim
7	Në 2013 Shqipëria do të ketë 160 mijë studentë
8	Internet në çdo familje brenda mandatit të ardhshëm
9	Çdo i ri shqiptar të ketë kompjuterin e tij
10	Çdo i ri që kërkon punë të mund të punësohet

¹ Sipas INSTAT, të punësuar janë personat në moshë pune që gjatë periudhës së referencës kanë patur një punë si të punësuar me pagë ose si të vetëpunësuar. Përfshihen edhe personat që kanë një punë por që kanë munguar përkohësisht në punë gjatë periudhës që shqyrtohet, për motive si sëmundje, trajnim, leje lindje etj. Ndërsa, ISSH publikon një numër të siguruarish në skemën e kontributeve deri 45% më pak se numri të punësuarve sipas INSTAT. Në këtë llogaritje të premtimeve do të ecet me të dhënat e raportimit të INSTAT, që lidhen edhe me Llogaritë Kombëtare etj.

² Qeveria merr përsipër kualifikimin, trajnimin dhe rikualifikimin e punëtorëve, paguan për ta primin dhe sigurimet shoqërore

11	Çdo i ri që krijon familje të ketë mundësi të krijojë strehën e vet
12	Nuk do ketë shkollë të mos jetë e re ose e rindërtuar
13	Përhapja e të mësuarit e-learning apo mësimi dixhital

PREMTIME POLITIKE

Nr.	Premtimi elektoral
1	Liberalizim i plotë i regjimit të vizave brenda vitit të parë të mandatit të dytë
2	Çojmë para ligjit këdo që kërkon të mbushë xhepat me paratë tuaja

PREMTIME PËR FSHATIN DHE BUJQËSINË

Nr.	Premtimi elektoral
1.	Urbanizojmë plotësisht gjithë pjesën e Myzeqesë
2.	4 vitet që vijnë do të pesëfishojmë rrënjët e ullirit në Shqipëri ³
3	Do të pesëfishojmë së paku grantet për prodhimet bujqësore
4	Investojmë 4 vitet e ardhshme për bujqësinë më shumë se në 70 vitet që shkuan
5	Çdo fshat do të ketë ujësjellës in e tij, çdo familje shqiptare do ketë ujin brenda shtëpisë
6	Lidhim fshatrat e komunave me rrugë të asfaltuara me qendrat
7	Importet, nafta, plehrat rimbursim me skemën anti-korrupsion
8	Financim çdo projekti për rritjen e prodhimit të fermerëve
9	Subvencionim naftës dhe importeve të tjera për sipërfaqet e mbjella
10	Rindërtim i plotë i sistemeve të vaditjes
11	Qeveria do ndërtojë dhe rindërtojë sistemin më modern të vadiljes
12	Me sistemin e kanalizimeve, pastrim i plotë i ujërave
13	Investime në agrobiznes dhe nxitje të përpunimit

PREMTIME PËR INFRASTRUKTURËN DHE VEPRAT PUBLIKE

Nr.	Premtimi elektoral
1	Asfaltuam 6000 km rrugë, asfaltojmë mandatin tjetër edhe 12000 km po të kishte
2	Autostrada Qafë Ploçë - Qukës, e cila do të përfundojë në fund të vitit 2010
3	Do të fillojmë ndërtimin e autostradës Tiranë-Elbasan
4	Rruga e Gjinarit, asfaltim Librazh-Qafë Ploçë, hyrja e Gramshit, Kuçovë-Belsh-Cërrik
5	Fillon ndërtimi i rrugës Baldushk-Papër
6	Shumë shpejt do të fillojë ndërtimin Boshti i Jugut që afron Sarandën me Tiranën
7	Ndërtojmë Parkun Industrial të Vlorës
8	Vlora ndër portet më të mëdha të Mesdheut me 50 mijë të punësuar, 2 miliard euro investim
9	Vlora do të ketë aeroportin e vet
10	Do të përfundojmë Rrugën e Arbrit
11	Do të përfundojmë rrugën Kardhiq-Delvinë
12	Tirana do të jetë në katër vite kryeqyteti me unazën më moderne dhe më të re në Europë
13	Qeveria do të mbështesë financimin projektit për ndërtimin dhe sistemimin e tregut çam
14	Rrogozhina do të nisë së shpejti by pass-in e saj

³ Më vonë deklarohet se do mbillen 20 milion rrënjë ullinj

15	Inaugurojmë Velipojë-Ulqin, së shpejti rruga Koman-Ferizë, së shpejti bypass i Shkodrës dhe Unaza e liqenit tuaj madhështor
16	Do të ndërtojmë rrugën e re Tiranë - Krujë - Qafë Shtamë

PREMTIME PËR ENERGJINË

N r.	Premtimi elektoral
1	Mandatin e dytë Shqipëria eksportues i rëndësishëm i energjisë elektrike në Ballkan
2	60 mijë të punësuar në hidrocentralet në gjithë Shqipërinë
3	Filloi ndërtimin Parku energjetik në Lezhë me ndërtimin e centralit me biomasë të lëngshme 140 MË, investim 1.1 miliard euro
4	Kemi gati 5.6 miliard euro investime në 104 hidrocentrale, në 6 parqe industriale, në 4 parqe energjetike
5	Shfrytëzimi i potencialeve ujore dhe Shqipëria superfuqi të vogël energjetike në rajon
6	Nuk do të ketë ndërprerje të energjisë për mungesë të saj

PREMTIME TË PËRGJITHSHME

N r.	Premtimi elektoral
1	Katër vitet që vijnë nuk do të ketë familje shqiptare që të mos ketë ujë 24 orë
2	Do të dyfishojmë prodhimin e naftës në katër vitet që vijnë
3	Do të shkurtojmë 5 vite pensionin e minatorëve dhe me efekt prapaveprues
4	Të gjitha blerjet e qeverisë do të bëhen në mënyrë elektronike
5	Do të krijojmë Qendrën Kombëtare, sportelin unik
6	80% të vlerës për legalizimet mund të paguhet me letra me vlerë
7	Ligji i parë që do miratojmë është ai për Gjykatën Administrative
8	Nuk do përdorim ndonjëherë vlerë tjetër përveç vlerës së tregut për kompensimin monetar apo fizik të pronarëve

PREMTIMET ZGJEDHORE TË PS, 2009

PREMTIMET FISKALE DHE BUXHETORE

Nr.	Premtimi elektoral
1	Brenda 50 ditëve të para të mandatit do të prezantojmë një paketë antikrizë
2	Do të bëj të prekshme 197,000 mundësi të reja punësimi
3	Ritme më të larta rritjeje ekonomike, për vitet 2011-2013 do të jetë mbi 6%
4	Ulje e papunësisë në 9%
5	Inflacion jo më shumë se 3% në vit.
6	Deficit buxhetor jo më shumë se 3%
7	Borxhi publik në vitin 2013 jo më shumë se 50% e PBB
8	Borxh publik vetëm për investime
9	Politika fiskale lehtësuese e nxitëse për teknologjitë moderne
10	Transparencë maksimale për çdo politikë fiskale dhe buxhetore
11	Bashkëpunim maksimal dhe efikas me Institucionet Financiare Ndërkombëtare
12	Do të përgjysmojmë nivelin e papunësisë në fshat dhe deri në fund të mandatit tone
13	Do të mbështesim veçanërisht punësimin e të rinjve dhe grave
14	Deri në vitin 2013 do të eliminohet puna e fëmijëve nën 16-vjeç në sektorin formal
15	Do të ulët informaliteti e parandalohet shfrytëzimi i fëmijëve në ekonominë gri
16	Do të eliminojmë çdo vonesë në rimbursimin e TVSH dhe çdo taksë dhe tatim të paguar më tepër
17	Rimbursimit të TVSH do t'i shtojmë incentivat fiskale për importin e makinerive të reja dhe investimet
18	Nxitje vetdeklarimit, çinstalim i sistemit të referencave, garantohet rimbursimi i TVSH-së
19	Do të heqim çdo ngarkesë fiskale për importet e teknologjive moderne dhe për ekonominë e dijes
20	Do të shfuqizojmë dhe hedhim poshtë ligjet anti – biznes
21	Rishikimi dhe përmirësimi sa më parë i çdo ligji ekonomik dhe fiskal që ka rritur vështirësitë për biznesin dhe ka inkurajuar abuzivitetin e administratës fiskale
22	Asnjë ligj dhe akt ligjor, nuk do të miratohet nga Parlamenti dhe qeveria pa u diskutuar me transparencë me komunitetin e biznesit dhe grupet e interesit
23	Do të mbështesim marrëveshjet për ristrukturim të kredive të këqija midis bankave dhe biznesit dhe do të propozojmë krijimin e një fondi garancie për likuiditet
24	Do ti jepet fund praktikave fiskale antiligjore e korruptive që rëndojnë bizneset

PREMTIMET PËR SHËNDETËSINË

Nr.	Premtimi elektoral
1	Do të ofrojmë mbulim universal me shërbim shëndetësor për të gjithë shqiptarët ⁴
2	Shërbimi shëndetësor që ne do të ngremë do të shtrihet në të gjithë vendin ⁵
3	Do t'u ofrojmë qytetarëve tanë, vëmendje ⁶
4	Do të koordinojmë sistemin e vërtetë publik me atë privat
5	Do të ofrojmë shërbime të sigurta ⁷
6	Do të vlerësojmë, akreditojmë dhe monitorojmë çdo ofrues të shërbimit shëndetësor publik dhe privat

⁴ pavarësisht nga të ardhurat e tyre, gjendja shoqërore, vendbanimi, gjinia apo mosha. Edhe pse një pjesë me peshë e forcës së aftë për punë në marrëdhënie pune nuk është e mbuluar me sigurime shëndetësore përsëri cdo individ do përfitojë nga shërbimi shëndetësor, nuk ka rëndësi nëse është i siguruar apo jo

⁵ do të mbështesë në të gjitha hallkat e ecures së kujdesit për shëndetin

⁶ gjatë gjithë zinxhirit të shërbimeve që ata kanë nevojë përfshirë parandalimin, trajtimin dhe rehabilitimin

⁷ku qytetarët do të kenë mundësinë të zgjedhin midis shërbimit shëndetësor publik apo atij privat

7	Do të mundësojmë që të gjitha barnat në Shqipëri të shiten kudo njësoj dhe jo më shtrenjtë sesa në tregun e vendit të origjinës
8	Do të rrisim cilësinë dhe sigurinë e barnave ⁸
9	Programi për shëndetësinë zgjidhje për parandalim, diagnostikim, kurim dhe rehabilitim
10	Me mjekët e talentuar e të përkushtuar shqiptarë ne do të rindërtojmë shëndetësinë shqiptare
11	Do të rivendosim besimin e tradhëtuar të shqiptarëve për shëndetësinë
12	Do të rivendosim dinjitetin e nëpërkëmbur të mjekëve
13	Do t'u ofrojmë mjekëve dhe infermierëve tanë njohuritë, shpërblimin dhe teknologjitë e nevojshme
14	Do të financojmë më shumë për shëndetin publik dhe programet e parandalimit
15	Do të reduktojmë sorollatjet dhe radhët duke përmirësuar planifikimin dhe koordinimin

PREMTIMET PËR ARSIMIN

Nr.	Premtimi elektoral
1	Do ta çojmë minimum 5% kontributin e buxhetit për arsimin
2	Abetaren dhe librat e shkollës do t'i japim falas për të gjithë fëmijët e varfër, jo me rimbursim, por drejtë e në dorë
3	Do ti japim vlerë diplomave duke bërë në 4 vjet më shumë se sa është bërë në 18 vjet
4	Unifikojmë modelin e programeve mësimore me Kosovën
5	Rritje e nivelit të frekuentimit të çerdheve dhe kopshteve deri në 40% për grupmoshën 0-3 vjeç
6	Do ta shndërrojmë Normalen e Elbasanit në një gjimnaz si gjithë të tjerët
7	Mbështetje të biznesit, që ka të bëjë me sistemin e taksave apo investimeve në fushën e arsimit dhe formimit profesional
8	Unifikimi i vërtetë i programeve tona shkollore me ato të Europës, për ta përmbushur kësajsoj ëndrrën që përkund çdo prind shqiptar për bijtë e vet!
9	Shkollimi me laboratorë moderne e mjete didaktike funksionale ⁹
10	Shpërblimi real i punës së arsimtarëve, duke mos u ndalur vetëm te paga po edhe te rivendosja e dinjitetit të tyre
11	Politika në raportin sistem publik–sistem privat, e shih privatin si partner të shtetit drejt synimit të përbashkët
12	Do të lindë edhe arsimit i vërtetë profesional në Shqipërinë ¹⁰
13	Shkollimi i gjithsekujt sipas talentit dhe aftësisë ¹¹
14	Do ta shpallim armik e do ta luftojmë me forcë të paparë analfabetizmin
15	Do të nisë epoka e re e rilindjes së Arsimit të çliruar nga zinxhirët e interesave politike

PREMTIMET PËR FSHATIN DHE BUJQËSINË

Nr.	Premtimi elektoral
1	Do të ngremë një ministri të posaçme për fshatin që do të quhet Ministria e Zhvillimit Rural
2	Do dyfishojmë menjëherë buxhetin e bujqësisë
3	Asnjë bujk dhe fermer pa certifikatën e pronësisë mbi token

⁸ duke shtuar kujdesin për indikacionet e barnave në përputhje me standardet europiane

⁹ ku mësues e pedagogë nuk detyrohen më të shpjegojnë me gishta

¹⁰ për ti ofruar biznesit punëtorë të kualifikuar dhe mundësi që ai të eci

¹¹ duke e shndërruar shkollën në një kultivuese të vërtetë dhuntish e mundësish

4	Biznesi Agrar do të përjashtohet nga taksat për 3 vite ¹²
5	Synojmë rritjen e ekonomisë rurale me aktivitete si: agroindustria, turizmi, bimët e egra dhe medicinale, produktet bio dhe artizanale, peshkimi, pyjet, gjuetia dhe agroturizmi
6	Çdo pronë që është e lirë do t'i kthehet pronarit, çdo tokë që është marrë me ligjin 7501, do t'i jepet menjëherë me letër dhe vulë pronarëve të saj, që janë ata që e kanë marrë me ligjin 7501
7	Do të subvencionojmë prodhimet bujqësore, që sot nuk arrijnë të shkojnë dot në tregun e qytet
8	Do të reduktojmë koston e lartë të prodhimeve, duke zhdukur akcizën e naftës
9	Nafta për prodhimin në fshat do të jetë pa akcizë
10	Do të ngremë një Agjenci të Biznesit Agrar, e cila do të ketë si funksione kryesore, monitorimin dhe garantimin e cilësisë së farave, fidanëve, pesticideve, të fertilizuesve
11	Do të ndërtojmë dhe aprovojmë në Parlament “Kodin e Tokës”
12	Do të përfundojmë regjistrimin në të gjitha zonat kadastrale të vendit
13	Do ta nxitim zhvillimin e tregut të tokës, duke ofruar qoftë lehtësi fiskale, qoftë lehtësi procedurale
14	Do të ndërtojmë një sistem të administrimit të tokës, duke unifikuar gjithë informacionin dhe duke ristrukturuar qoftë kadastrën ligjore ¹³
15	Bizneset agrare të reja ne do t'i përjashtojmë nga çdo tatim fitimi dhe çdo taksë në 3 vitet e para
16	Inventarizim i plotë i pronës në tërësi dhe tokave bujqësore
17	Dhënie e certifikatave të pronësisë atyre që u takon me ligj
18	Mbyllim procesin e certifikimit të pronësisë mbi tokën bujqësore mbi bazën e ligjit 7501
19	Rritja e mirëqenies në fshat dhe garantimi i pronës dhe i sigurisë social-ekonomike
20	Asnjë familje shqiptare në fshat pa ndihmën e shtetit, duke filluar nga nënat e reja që fitojnë lejen e barrëlindjes
21	Asnjë bujk, fermer e peshkatar pa shtetin pranë për të ulur kostot e prodhimit dhe garantuar infrastrukturën e tregut të shitjes së tij
22	Arsimim profesional për të rejat e të rinjtë e fshatit, shërbim shëndetësor për të gjithë dhe një plan tërësor për rindërtimin e marrëdhënieve mes fermerit e shtetit

PREMTIMET PËR MJEDISIN

Nr.	Premtimi elektoral
1	Do të mbjellim në Shqipëri më shumë pemë se ç'janë mbjellë në këto 18 vjet të marra së bashku
2	Do ta pastrojmë Shqipërinë nga plehrat e kudondodhura nëpër rrugët urbane dhe ato kombëtare e nga mbeturinat urbane
3	Integrim të komponentes mjedisore në politikat ekonomike të zhvillimit të vendit
4	Adoptim të politikave që mundësojnë shfrytëzimin racional e të qëndrueshëm të natyrës
5	Ndërhyrje energjike me faktorë financiarë, menaxhues dhe instrumente ligjore për të penguar degradimin e natyrës
6	Mbrojtje të mjedisit me një përqasje të re, duke e konsideruar dhe menaxhuar atë në mënyrë integrale
7	Partneritet serioz në bashkëpunimet bilaterale dhe multilaterale ¹⁴
8	Arritje të standardeve mjedisore, për rehabilitimin e zonave të ndotura, të pyjeve, për uljen e ndotjeve në ajrin urban, në ujërat sipërfaqësore dhe për zvogëlimin e erozionit
9	Do ta ndalim këtë shkatërrim, pasuritë tona të përbashkëta t'i vëmë në dispozicion të shoqërisë ¹⁵
10	Asnjë qesë plastike nuk do të hidhet më në Shqipëri, plazhe, lumenj, rrugë, parqe, oborre

¹² Do të mbështesim prodhimin vendas nëpërmjet zhvillimit, profilizimit dhe konsolidimit të Biznesit Agrar në një treg funksional

¹³ që është Zyra e Regjistrimit të Pasurive, por nga ana tjetër duke krijuar Kadastrën Shumëqëllimshme

¹⁴ si dhe me konventat ndërkombëtare për të përmbushur, jo thjesht në letër detyrimet që rrjedhin prej tyre

¹⁵ duke ndryshuar rrënjësisht dhe marrëdhëniet me zonat rurale

PREMTIMET PËR MBROJTJEN SOCIALE

Nr.	Premtimi elektoral
1	Do të shpallim edhe minimumin jetik ¹⁶
2	Brenda mandatit të ardhshëm qeverisës, do të 4-fishojmë ndihmën ekonomike për shtresat në nevojë
3	Angazhohemi për një politikë të re që do të rimëkëmbë arsimin, ku librat e shkollës do t'i japim falas për çdo fëmijë të varfër
4	Do krijojmë Fondin e Integritimit Social ¹⁷
5	Do të përgjysojmë nivelin e varfërisë në vend brenda mandatit
6	Duam që të krijojmë për çdo shqiptar e shqiptare, Kartën Sociale ¹⁸
7	Komision për identifikimin e nevojave dhe të problemeve që ka komuniteti egjiptian
8	Një mekanizëm që me të vërtetë fëmijët jetimë pa nënë ose pa baba, të garojnë të barabartë në fushën e jetës me të gjithë fëmijët e tjerë
9	Zëvendësojmë ndihmën ekonomike si lëmshë me ndihmën si mundësi reale për punësim
10	Rritje e punësimit dhe shërbimeve sociale për gratë dhe vajzat
11	Do të rishikohet sistemi i vlerësimit të paaftësisë, duke kaluar nga një vlerësim thjesht mjekësor, në vlerësim mjekësor dhe social
12	Individët që u shërbejnë personave me aftësi të kufizuara, vitet që kalojnë pranë tyre do tu llogariten si vite pune për efekt pensioni
13	Rritje e rimbursimit të karburantit për personat me aftësi të kufizuar
14	Punësimi do të jetë për ne kryefjala e përpjekjes tonë dhe çdo njeri i papunë do të jetë njëri nga ne që ka nevojë për ndihmë
15	Ndryshim radikal në treguesit statistikor të pjesëmarrjes së grave në politikë dhe ekzekutiv

PREMTIMET PËR MINATORËT

Nr.	Premtimi elektoral
1	Do të përcaktojmë kufirin e veçantë për pension për moshën e minatorëve ¹⁹
2	Ne angazhohemi solemnisht përpara jush se ajo kërkesë legjitime e kahershme, që ka të bëjë me statusin e minatorit, do të merret nga ne parasysh ²⁰
3	Për kategorinë e atyre që nuk punojnë dot dhe nuk e kanë arritur moshën e pensionit, nuk do i japim më trajtimin e veçantë prej 6.500 lekësh, por pensionin minimal
4	Do t'u lidhen pensione fëmijëve të minatorëve për dhënie fund të trajtimit të tyre nga koncesionarët pa kushte pune
5	Do t'i qëndrojmë mbi kokë për ditë çdo koncesionari, çdo sipërmarrësi që ka një kontratë me shtetin për shfrytëzimin e minierave ²¹
6	Masa për kushtet elementare të sigurisë në miniera

¹⁶ nuk do të lejojmë që të ketë familje shqiptare nën minimumin jetik, duke filluar nga pagesa e papunësisë, që së paku do ta dyfishojmë

¹⁷ Ky fond brenda 2010 do bëjë që familjet e varfëra të përfitojnë 50% më shumë. Në 2011 përfitimi do të jetë dyfish. Në fund të mandatit të parë përfitimi i ndihmës ekonomike 4 herë më i madh

¹⁸ e cila është një kartë që në bazë të profilin individuale dhe gjendjes shoqërore e ekonomike, t'i japë mundësi çdo qytetari e qytetareje të përfitoj në mënyrë të thjeshtë dhe tërësisht transparente shërbime e kujdes social e shëndetësor, arsimor, apo kulturor

¹⁹ për minatorët ne do ta frenojmë moshën e pensionit qysh në janarin e vitit 2010

²⁰ dhe do të kthehet në realitet në 100 ditët e para të qeverisjes sonë

²¹ dhe do të kërkojmë kushte të standardeve europiane, mbi dhe nën tokë

PREMTIMET PËR EMIGRANTËT

Nr.	Premtimi elektoral
1	Ne do të lidhim marrëveshje me Greqinë dhe Italinë për njohje reciproke të periudhës së sigurimit për efekt pensioni
2	Krijimi i mundësive për të votuar jashtë Shqipërie është një objektivi plotësues i yni pas 28 qershorit ²²
3	Kanali i dytë i televizionit publik për mësimin e gjuhës shqipe në çdo cep të globit ku jetojnë shqiptarë
4	Transformim i shërbimeve në ambasada dhe konsullata për shqiptarët e shqiptarët
5	Emigrantët e emigrantet shqiptarë të mund të aplikojnë dhe të marrin pasaportën biometrike ²³
6	Paketë stimuluese për investimet në ekonominë rurale ²⁴
7	Do të bëjmë gjithçka me qeverinë greke për të rritur numrin e shkollave shqipe

PREMTIMET PËR INTEGRIMIN

Nr.	Premtimi elektoral
1	Kemi parashikuar hapa konkretë që përmbushin detyrimet për liberalizimin e vizave brenda 6 mujorit të parë të qeverisjes
2	Do marrë të gjitha masat ²⁵ dhe do ketë angazhimin maksimal për ta bërë vendin tonë anëtar të BE
3	Do të përshpejtojmë reformat që synojnë menaxhimin në mënyrë të decentralizuar të fondeve të paraqiturit ²⁶

PREMTIMET PËR LEGALIZIMET DHE PRONAT

Nr.	Premtimi elektoral
1	Legalizimet, ne do t'i kryejmë brenda mandatit tonë të parë ²⁷
2	Që në vitin e parë, do të rregullojë të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore, lidhur me qeramarrjen e tokës, me shitblerjen e tokës dhe me ruajtjen e tokës ²⁸
3	Inventarizim i plotë i pronës duke i dhënë fund abuzimit dhe korrupsionit qeveritar
4	Do të fillojë fundi i kaosit për hapësirat informale, investime në kanalizime, rrugë, ndriçim, çerdhe, kopshte e shkolla
5	Komitet Shtetëror të Zhvillimit të Rrethinave ²⁹
6	Ndëshkim për abuzimet dhe korrupsionin me pronat

²² Vota e emigrantëve është një mungesë e qënësishme në procesin tonë demokratik. Hera e fundit që për të shprehur vullnetin tuaj juve duhet të bëni rrugë për të shkuar në qytetin apo fshatin tuaj në Shqipëri, herën tjetër ne do të garantojmë votën tuaj nga këtu ku jeni

²³ në një sërë sportesh kryesore, në Evropë, Amerikë, Kanada,

²⁴ të të gjithë atyre burimeve dhe grave, djemve dhe vajzave, emigrantë që çojnë kursimet e tyre drejt fshatit ku jeton familja e tyre

²⁵ Qeveria e re, e cila ka në themel të programit të saj integrimit e vendit

²⁶ që kanë të bëjnë me zhvillimin rajonal, rural dhe zhvillimin e burimeve njerëzore

²⁷ Mbyllje e plotë e procesit të legalizimeve të shtëpive dhe hapjen e një fondi të posaçëm për kanalizimet, ujësjellësit, rrugët, çerdhet, kopshtet, shkollat dhe gjithçka duhet

²⁸ PSSH shpreh edhe njëherë besimin se zgjidhja përfundimtare e ceshtjes së pronës do të takojë qeverisjes së saj të pas zgjedhjeve, harmonizimit të interesave të pronarëve me ato të të gjithë shqiptarëve

²⁹ për t'iu dhënë të gjithë të ardhurave që jetojnë në mjerrimin e zonave informale, politikën e re të integrimit urban

PREMTIMET POLITIKE

Nr.	Premtimi elektoral
1	Auditim keqpërdorimit të fondeve të buxhetit për reklama dhe spote qeveritare
2	Do ta zhveshim administratën publike nga “sistemi i favoreve politike e korruptive” ³⁰
3	Do të mundësohet një reformë reale në drejtësi me konsensus publik dhe institucional
4	Do korrigjojmë dëmet e shkaktuara nga legjislacioni antikushtetues, pa fuqi juridike
5	Do marrë fund sjellja mbyhtëse ndaj sipërmarrjes dhe pozicionet monopoliste
6	Bëjmë gjithçka për të forcuar pavarësinë kushtetuese e financiare të sistemit gjyqësor
7	Harta e investimeve në rrugët para e pas 2005, por edhe transparencë abuzimeve

PREMTIME TË PËRGJITHSHME

Nr.	Premtimi elektoral
1	Zgjidhje për situatën monopol në tregun e hidroarbureve
2	Mbështetje 606 naftëtarëve të Ballshit për pagat e prapambetura
3	Merr fund epoka e televizionit të pushtetit dhe nis epoka e televizionit të qytetarëve (RTSH)
4	Do të përfundojmë rrugën Durrës-Kukës
5	Elementët e provueshëm të dhunës në familje do ti bëjmë pjesë të krimeve penale
6	Zbatim i vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe njohje e detyrimeve të qeverisë ndaj ish-ushtarakëve
7	Sistem licensimi dhe vlerësimi të njësisve hotelerie në bazë të standarteve europiane
8	Do të ndërtojmë një strukturë të integruar të sigurisë kombëtare
9	Do të uniformojmë trupat policore në Policinë e Shtetit
10	Fillimi i ndërtimit të një porti europian dhe fillimi i punës për një universitet europian për Vlorën
11	Do t'i japim fund etjes së Tiranës dhe do të kemi 24 orë ujë në të gjithë Qarkun e Tiranës
12	Kerkese per hetim per Gerdecin, Rrugen e Kombit, Albtelekomin, ARMO, INSIG, blerjet energjise, tokat e Porto-Palermo, fabrikat e cimentos, HEC Devolli dhe grabitjet e tokave ne bregdet dhe Kinostudio.

³⁰ Kush përdor paratë publike në kundërshtim me ligjet do përgjigjet penalisht. Do të lëvizim dhe do të vijmë tek ju, për t’ju folur dhe dëgjuar e për të vendosur së bashku edhe nesër kur të jemi në qeveri

PREMTIMET ZGJEDHORE TË LSI, 2009

PREMTIMET FISKALE DHE BUXHETORE

Nr.	Premtimi elektoral
1	Për çdo biznes të ri që do punësojë më shumë sesa pesë veta do të heqim tatim fitimin për disa vite
2	Do të rishikojmë politikën e taksave për të ardhurat e individit, duke përfshirë nga tatimi mbi të ardhurat të gjitha pagat deri në 25 mijë lekë të reja në muaj
3	Përgjysmimi i TVSH-së për këto produkte ³¹ nga 20% në 10 %
4	Do të subvencionojmë energjinë për 300 kilovat/ orë në muaj për familjarët e varfër
5	Për çdo vend të ri pune që do të krijohet do të - heqim tatimin mbi fitimin deri në Dhjetor të vitit 2010, - subvencionojmë sigurimet shoqërore në masën 50 për qind deri në fund të vitit 2011, dhe - subvencionojmë 100 % sigurimet shoqërore
6	Do të synojmë që pagat në administratën publike të jenë plotësisht të konkurueshme me ato në sektorin privat

PREMTIMET PËR SHËNDETËSINË

Nr.	Premtimi elektoral
1	Garantimi i një shërbimi mjekësor gjithnjë e më pranë qytetarëve ³²
2	Krijimi i një urgjence kombëtare të arritshme nga çdo qytetar dhe me teknologjinë e duhur
3	Rritje e menjëhershme e financimit të shëndetësisë në PBB deri në minimumin 4% në fund të mandatit qeverisës
4	Ndërtimi i një skeme të sigurimeve shëndetësore reale që garanton e mbulon plotësisht qytetarët për shërbimin parësor të tyre ³³
5	Realizimi i rajonalizimit të spitaleve në nivel të çdo qarku ³⁴
6	Ndryshimi rrënjësor i spitaleve tona duke nxitur e mbështetur autonominë e tyre dhe sigurimi i një shërbimi mjekësor spitalor me cilësi
7	Sigurimi i një kontrolli sanitar dhe epidemiologjik intensiv, profesional dhe të mbështetur me kompetencat ligjore të duhura
8	Sigurimi i shërbimit mjekësor të specializuar për të moshuarit në të gjitha spitalet e vendit

PREMTIMET PËR ARSIMIN

Nr.	Premtimi elektoral
1	Paga e mësuesit do të dyfishohet brenda mandatit të ardhshëm qeverisës
2	Brenda 4 viteve të ardhshme do të ristrukturojmë mbi 80 përqind infrastrukturën e shkollave

³¹ Plan për të ulur koston e jetesës, sidomos për produktet bazë, për produktet e shportës, si vaji, orizi, makaronat etj. në mënyrë që të ndihmojmë në uljen e çmimeve

³² Duke siguruar funksionimin e qendrave shëndetësore edhe në fshatrat me te largeta dhe mbulimin me personel mjekësor të tyre

³³ nga vizita mjekësore, ekzaminimet e deri tek lista e plote e barnave që rimburohen si dhe mbulimit prej saj të një shërbimi spitalor cilësor dhe të ndershem

³⁴ duke standartizuar veprimtarinë, personelin shëndetësor të nevojshëm, infrastrukturën dhe teknologjinë mjekësore perkatese

3	Brenda 4 viteve të ardhshme do të realizojmë decentralizimin e plotë të shkollës me qëllim rritjen e efektivitetit të saj
4	Heqja e menjëhershme e TVSH nga shërbimet e arsimit, si dhe ulja e detyrimeve të tjera, duke përfshirë edhe tatimin mbi fitimin
5	Do të vendosim një partneritet solid midis sektori publik dhe atij privat të arsimit
6	Diplomat e studentëve që përfundojnë arsimin e lartë, të duhet të jenë në përputhje me kategoritë dhe mundësitë e punës
7	Minimalizimi i braktisjes së shkollës duke ndryshuar ligjin ekzistues ³⁵
8	Ne do t'i kthejmë shkollat në qendra të integruara për shërbime komunitare
9	Paketa jonë e Bonusit jetik parashikon subvencionimin e plotë të librave për familjet e varfra, një masë që do ndikojë në zbutjen e braktisjes së shkollës
10	Do të krijojmë mundësi për kreditimin e studimeve universitare nga bankat, pa interes, për ata studentë që kanë nevojë
11	Mësimi i gjuhës shqipe nga emigrantët do të jetë pjesë e rëndësishme e reformës sonë arsimore
12	Do të punojmë për të krijuar filiale të universiteteve në qytetet më të rëndësishme
13	Rikonceptim të reformës së Maturës Shtetërore
14	Do të punojmë që rinia të ketë sa më shumë ambiente sportive
15	Do të përmirësojmë në mënyrë të ndjeshme raportin midis shkollës së mesme profesionale dhe shkollës së përgjithshme
16	Kërkimi shkencor është një prioritet shumë i rëndësishëm

PREMTIMET PËR BUJQËSINË

Nr.	Premtimi elektoral
1	Krijimi dhe zhvillimi i tregut të tokës për ne është abc-ja e zhvillimit të këtij sektori
2	Do të konsolidojmë pronësinë mbi tokën dhe të zgjerojmë tregun e saj
3	Zgjidhja e çështjes së pronësisë ³⁶
4	Synohet që deri në vitin 2010 të dyfishohen investimet për bujqësinë
5	Subvencionim për njësi produkti ³⁷ , pra subvencione për çdo kg mish, grurë, fruta apo litër qumësht të prodhuar
6	Krijimi i markave e brandeve ³⁸ që do të konkurojnë nesër në tregun e eksporteve, por edhe që do të furnizojnë në mënyrë atraktive industrinë turistike në vend
7	Stimujt fiskalë do të përqendrohen në mënyrë të veçantë tek agro-përpunimi, ku do të përjashtojnë nga tatimi mbi fitimin për tri vitet e para çdo biznes agro-përpunues ³⁹
8	Do të ketë një fond të veçantë për garanci kreditimi, si dhe do të ketë zbritje të konsiderueshme nga tatimi për bizneset agro-përpunuese për punësimin
9	Bonusi jetik dhe punësimi jetik do të jenë pjesë themelore e politikës sonë edhe në fshat, pasi aty është edhe varfëria më e madhe
10	Do të krijohen lehtësira fiskale për bizneset e reja prodhuese

³⁵ me synimin për t'i dhënë përparësi masave parandaluese në këtë drejtin dhe jo thjeshtë atyre ndëshkimore. Arsimimi i çdo fëmije është një e drejtë e tyre dhe një detyrim i shtetit

³⁶ për të çliruar miliarda euro në qarkullimin ekonomik

³⁷ modeli ynë subvencionues nuk do të jetë as fiktiv e as klientelist. LSI do të zbatojë politika mbështetëse dhe subvencionuese nga shteti, që nga farërat, plehrat kimike, punimi i tokës, investimet për makineri bujqësore, subvencionimi për njësi prodhimi. Subvencionimi i inputeve bujqësore në masën 25 për qind, për të vazhduar me subvencionimin e prodhimeve përmes parimit "kush prodhon më shumë, të subvencionohet më shumë"

³⁸ synimi ynë kryesor

³⁹ hallka më e lënë pas dore e zinxhirit agro-industrial sot, ku do të jepen garancitë për kreditim dhe paketa stimujsh fiskalë

11	Investimi në kualifikimin profesional të të rinjve dhe fermerëve në fushën e bujqësisë ⁴⁰
12	Përmes krijimit dhe zhvillimit të industrisë agropërpunuese, në 4 vitet e ardhshme të krijojmë 30 mijë vende të reja pune në të gjithë Shqipërinë
13	Do të ndërtojmë një flotë të re peshkimi ⁴¹

PREMTIMET PËR MBROJTJEN SOCIALE DHE PUNESIMIN

Nr.	Premtimi elektoral
1	Punësim për çdo familjar që ka nevojë për të punuar për të siguruar të ardhura ⁴²
2	“Plani ynë për Veprim” është plani që ndihmon gati 1 milion shqiptarë që të kapërcejnë njëherë e mirë pragun e varfërisë
3	Kemi një plan real, të mirëstudiuar dhe konkret për krijimin e 100.000 vende të reja pune, në të gjithë sektorët, veçanërisht ata që lidhen me agro-industrinë e agro-turizmin
4	20 mijë vende pune mund të hapen për të gjithë ata të rinj apo të gjithë ata shqiptarët që do të dëshironin të punësoheshin në transportin detar
5	Punësimi ⁴³ do të motivohet me skema incentivash konkrete fiskale
6	Kemi qëllimin e punësimit të plotë të shqiptarëve brenda mandatit të ardhshëm ⁴⁴
7	Punësim për të gjithë shqiptarët që dëshirojnë të sigurojnë një vend pune brenda katër viteve të ardhshme ⁴⁵
8	Do të propozojmë paketën e bonusit jetik, një paketë parash në <i>cash</i> , incentivash fiskale, dhe politikash të tjera
9	Në reformën e asistencës sociale do të institucionalizojmë modelin e “punësimit jetik”
10	Kushtëzim përftimit të ndihmës ekonomike kryesisht me punësimin në sektorin publik dhe sferën komunitare
11	LSI ka paraqitur në Kuvend projektligjin për kujdesin ndaj moshës së tretë dhe propozojmë një pension të 13-të për çdo person të moshës së tretë
12	Ngritje të institucioneve të kujdesit për moshën e tretë nga pushteti vendor në gjithë vendin
13	Rimbursim të plotë të çdo medikamenti që përdor moshën e tretë
14	Transport urban falas apo me gjysëm cmimi, Sherbim shëndetësor në familje falas, strehim me prioritet për moshën e tretë, Pagesë minimale për pensionistët që jetojnë në shtëpi me të paafte të tjera ⁴⁶
15	Do të favorizojmë me lehtësira fiskale, në veçanti, bizneset që punësojnë gra e sidomos ato që punësojnë kryefamiljare
16	Do të mbështesim konkretisht gratë që synojnë të hapin biznese ⁴⁷
17	Do të aplikojmë një sistem totalisht të ri të kontrollit shëndetësor duke ofruar shërbime falas për gratë, për vaksinimin dhe patologjitë specifike që prekin ato

⁴⁰ duke nxitur shkollat tekniko-profesionale. Qeveria të ndërmarri politika reale dhe jo fiktive të formimit profesional

⁴¹ që të jetë shumë agresive për të rritur kapacitetet e peshkimit, për të shfrytëzuar këto resurse të jashtëzakonshme, që i ka dhuruar natyra vendit tonë

⁴² ne nuk premtojmë çekun e bardhë

⁴³ prioriteti ynë i parë

⁴⁴ Në themel të gjithë angazhimit tonë të ardhshëm dhe qeverisë do të jetë punësimi dhe vecmas punësimi për jetimët

⁴⁵ angazhimi ynë solemn përpara gjithë të rinjve dhe përpara gjithë shqiptarëve

⁴⁶ Keto shërbime që propozon projekt-ligji i LSI për moshën e tretë kanë një fakturë financiare që nuk e kalon 70 milion dollarë në vit. Rimbursimi i plote i ilaçeve kushton rreth 25 milion dollarë në vit. Pensioni suplementar, mbi gjelën e ditës që jepet nga qeveria çdo vit, kushton 26.6 milion dollarë. Të gjitha shërbimet e tjera nuk kalojnë nivelin 20 milion dollarë.

⁴⁷ sepse besojmë të shpirti sipërmarrës i gravë sepse, në fund të fundit, çdo grua është një administratore qoftë dhe e atyre punëve dhe problemeve të shtëpisë

18	Të gjitha gratë kryefamiljare do të marrin ndihmë ekonomike të plotë dhe do të ketë një politikë të veçantë nga ana e qeverisë dhe shtetit për to
19	Do të garantojmë strehim, punësim dhe arsim për komunitetin rom dhe atë egjiptian

PREMTIMET PËR INFRASTRUKTURËN

Nr.	Premtimi elektoral
1	Do ta përfundojmë dhe do ta inagurojmë Durrës-Kukës të gjithë së bashku
2	Do të jetë përgjegjësia, nderi dhe privilegji ynë të përfundojë edhe rrugën e Kosovës edhe rrugën e bregdetit
3	Ndërtimi i rrugës së Arbrit është një domosdoshmëri
4	Do të ndërtojmë në Durrës, Portin më të fuqishëm në Ballkan
5	Karaburunë do të shndërrohet në perlën turistike të gjithë Mesdheut
6	Do ta kthejmë Lezhën në një perlë të Adriatikut tonë ⁴⁸

PREMTIMET PËR FASONËT

Nr.	Premtimi elektoral
1	Të garantohen lehtësira fiskale për këtë industri ⁴⁹
2	Qeveria të subvencionojë sigurimet shoqërore për punonjësit. Të bëhet në kohë rimbursimi i TVSH
3	Subvencionim në masën 50 %, të sigurimeve shoqërore për punëdhënësit deri në Dhjetor 2011 dhe heqjen e tatim-fitimit deri në Dhjetor 2010
4	Qeveria dhe Banka të mundësojnë ristrukturimin e kredive për bizneset fason

PREMTIMET PËR MINATORËT, NAFTËTARËT DHE USHTARAKËT

Nr.	Premtimi elektoral
1	Projektligji i paraqitur nga LSI për Statusin e minatorit ⁵⁰
2	Në mënyrën më të padrejtë është mohuar “Statusi i Ushtarakut” ⁵¹
3	Do të hapim 6 mijë vende të reja pune, në sektorin e naftës
4	Garanton statusin e naftëtarit, dhe pagesën e plotë për ish-punonjësit e ARMO-s

PREMTIMET PËR LEGALIZIMET, PRONAT DHE MORATORIUMIN

Nr.	Premtimi elektoral
1	Ne garantojmë legalizimin për t'i dhënë fund kësaj drame që keni ju gati dy dekada

⁴⁸ që të konkurojë me dinjitet edhe perlat e Adriatikut në Itali

⁴⁹ Koha për Veprim, që të ndihmojmë këta biznese (fason) që punësojnë mijëra shqiptarë

⁵⁰ LSI shpreh edhe një herë tjetër vendosmërinë e saj për bashkëpunuar në mënyrë që Parlamenti i Shqipërisë dhe qeverisja e ardhshme të vlerësojë kontributet dhe sakrificat e këtyre njerëzve. Meta garanton minatorët për miratimin e statusit të minatorit dhe uljen e moshës së pensionit pas fitores së LSI në 28 Qershor

⁵¹ Pas 28 Qershorit, kur Berisha pa diskutim që do të shkojë në opozitë dhe do të dalë në pension, pa diskutim që do të zbatohet vendim nr.9 i Gjykatës Kushtetuese i vitit 2007

2	Zgjidhja dhe konsolidimi i çështjes se pronesise ne Shqiperi ⁵²
3	Do të shfuqizojmë moratoriumin për mjetet e vogla lundruese

PREMTIMET PËR EMIGRANTËT⁵³

Nr.	Premtimi elektorale
1	Do të bëjmë gjithçka për të njohur të gjitha sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe të gjitha llojet e tjera të sigurimeve të vëllezërve e motrave tanë emigrantë
2	Do të favorizojmë investimet e emigrantëve në Shqipëri

PREMTIME POLITIKE DHE PËR INTEGRIMIN

Nr.	Premtimi elektorale
1	Lufta me program konkret kundër varfërisë dhe kundër monopoleve ⁵⁴
2	Kundër mënyrës se privatizimit të OSSH sh.a. Ky do të jetë një nga privatizimet që do të rishikohet menjëherë me ardhjen në qeveri ⁵⁵
3	Do të realizojmë heqjen e vizave brenda rajonit deri në fund të vitit 2009, dhe do të realizojë lëvizjen e lirë në BE brenda një viti.

⁵² është prioritet i programit qeverisës të LSI

⁵³ LSI ka insistuar gjithnjë për të drejtën e votës së emigrantëve, aty ku ata punojnë dhe banojnë

⁵⁴ Do ta çlirojmë Shqipërinë nga monopolet e Sali Berishës apo të kujtdo tjetër

⁵⁵ ne po e deklarojmë zyrtarisht që nuk do ta pranojmë këtë privatizim

PD 2009

Burimet e informacionit nga media online dhe deklaratimet publike të liderëve të partisë në fushatën elektorale

27/03/2009

Ne u kemi dhënë universiteteve publike 1 mijë vende shtesë vetëm për ju, por unë ju garantoj ju se ne jemi të gatshëm t'u japim edhe 2 mijë vende, mjafton që ne të arrijmë t'i mbushim ato, mjafton që ne të arrijmë të rikthejmë trurin tonë në vend dhe të njëjtin qëndrim do të adaptojmë pa asnjë dallim ndaj universiteteve private.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10652>

27/03/2009

Në 1 maj të këtij viti, ne dyfishojmë pensionet e të gjithë fermerëve shqiptarë dhe unë ju jap fjalën se do të qëndroj i vendosur deri në barazimin e këtyre pensioneve me ato të qytetit.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10654>

28/03/2009

Lufta kundër korrupsionit ka qenë dhe mbetet një përparësi madhore e jona. Në katër vite, ju keni parë që janë penalizuar mbi 140 zyrtarë. Unë ju jap fjalën se, për aq kohë sa të qeverisim ne, do të bëjmë çdo përpjekje për të vendosur para ligjit këdo që kërkon të mbushë xhepat me paratë tuaja.

Kemi rritur rrogën mesatare të administratës me 68 për qind, dyfishuar rrogat e arsimtarëve, në një maj dyfishojmë rrogat e mjekëve, në 1 maj dyfishojmë pensionet në fshat, ndërkohë që pensionet në qytet i rrisim nga 48 – 70 për qind, në 4 vjet.

Së pari, shëndetësia. Unë e di që sot janë jo të paktë qytetarët që kanë pakënaqësi ndaj këtij sistemi. Por, ne jemi të sigurt se katër vitet që vijnë, në këtë sistem do të luftojmë me efikasitet më të madhe korrupsionin, ne jemi të sigurt se katër vitet që vijnë ne do të krijojmë një partneritet publik-privat të shkëlqyer, do i japim mundësi blerjes dhe shërbimeve më të mira për qytetarët shqiptarë, do hapim garën e shërbimeve, do t'i japim të drejtën qytetarit që ai t'i blejë apo t'i marrë këto shërbime aty ku ai preferon dhe i gjykon cilësisht më të larta. Kjo do të thotë se duhet të shtrijmë sigurimet edhe në drejtëm të sektorit privat, duke mbështetur sektorin publik, duke mbështetur të gjithë ata që nuk kanë mundësi. Pra, kur them që këto shërbime t'i blejë qytetari, e kam fjalën që t'i blejnë sigurimet për të. Pra, kjo reformë mbetet një përparësi absolute.

Së dyti, reforma në arsim. Do të bëjmë çdo përpjekje që çdo i ri shqiptar të ketë kompjuterin e tij. Përpjekja është e vështirë, por nuk ka dhuratë më të mirë sesa një kompjuter, sesa shkolla për fëmijët tanë.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10657>

01/04/2009

Duke uruar qytetarët shqiptarë për ditën e madhe të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, Kryeministri siguroi se pas këtij akti, më i madhi në historinë tonë kombëtare, pas pavarësisë, do të vijohet me liberalizimin e plotë të vizave, në mënyrë që të gjithë shqiptarët të udhëtojnë si qytetarë të lirë në mbarë Evropën. Gjithashtu, Kryeministri theksoi se, më tej, do të vijohet me hapa shumë të mëdha në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian.

Në rast se në këtë mandat ne ia dolëm që të lidhnim, në qarkun tuaj, çdo qendër komune me akset kombëtare, nëpërmjet rrugëve të asfaltuara, në mandatin tjetër do të lidhim fshatrat e komunave me rrugë të asfaltuara, me qendrat e komunës.

Në katër vjet, ne kemi investuar në zonat rurale 1.6 miliardë e dollarë, janë investuar më shumë se 18 vite të marra së bashku. Unë u premtoj ju, fermerëve te Peqinit, të qarkut të Elbasanit dhe të gjithë Shqipërisë, se gjatë katër vitet e tjera të mandatit tonë të dytë, këto investime do të jenë trefish më të mëdha.

Së shpejti, ne nisim rrugën Qafë Plloc-Qukës, sikundër gjatë këtij viti nis ndërtimi i autostradës së re, Tiranë-Elbasan, e cila shkurton distancën tuaj me kryeqendrën e vendit. Ne do të ndërtojmë rrugën e Gjinarit, për të cilën janë parashikuar në buxhet 416 milionë lekë. Ne do të asfaltojmë rrugën, Librazhd-Qafë Plloçë, loti i dytë, me një fond 560 milionë lekë. Ne do të asfaltojmë hyrjen e qytetit të Gramshit, investim prej 37 milionë lekë, do të asfaltojmë rrugën Kuçovë-Belsh-Cërrik, me vlerë 877 milionë lekë. Gjithashtu, rruga Qafë Plloçë-Qukës, është një investim prej rreth 100 milionë dollarë, ndwrkohw qw do riveshim segmentin rrugor Elbasan- Cërrik-Gostimë, investim prej 18 milionë lekësh.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10680>

09/04/2009

Duam të urbanizojmë tërësisht Myzeqenë, sepse duam të ofrojmë infrastrukturën më moderne, shkolla, ujësjellës, kanalizime, rrugë. Ne kërkojmë votën sepse, në mandatin e dytë ne e shndërrojmë Shqipërinë në një eksportues të rëndësishëm të energjisë elektrike në Ballkan dhe më gjerë

Ndërsa në mandatin e dytë, Shqipëria do të shndërrohet në një eksportues madhor të energjisë në Ballkan. Vetëm në këto dy muaj nisin punimet për 20 hidrocentrale, vetëm këto dy muaj nisin punimet për parqet e erës, vetëm këto dy muaj shtohen burimet reja, si termocentrali i Vlorës. Pra, ne kërkojmë votën tuaj për ato që do të bëjmë.

Në 3 vjet e 8 muaj ne kemi investuar 1 miliardë e 600 milionë dollarë në fshatrat e Shqipërisë, në mandatin e dytë ne do të investojmë 2 herë më shumë se në mandatin e parë për fshatin shqiptar.

Më lejoni t'ju premtoj se, pas anëtarësimit në NATO, stacioni i dytë madhor i përbashkët do të jetë heqja e plotë e vizave për shqiptarët.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10764>

10/04/2009

Në këto 4 vite, ne kemi dyfishuar buxhetin, kemi investuar në sistemin arsimor 4 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto. Këto 4 vite, duke filluar nga data 1 maj, të gjithë mësuesit e Shqipërisë do të marrin një pagë dy herë më të madhe, sesa në vitin 2005.

Në 4 vite, në Shqipëri janë rindërtuar ose ndërtuar të reja 1012 shkolla. Unë dua t'ju jap fjalën se në 4 vitet që vijnë nuk do të ketë shkollë në Shqipëri që të mos jetë e re ose e rindërtuar. Ju do të mësoni në shkolla dinjitoze, në shkolla të reja, me sistem ngrohjeje, me kabinete informatike, me terrene sportive, në shkollat që ju meritoni.

Duke filluar nga muaji maj, në të gjitha shkollat e Shqipërisë do të ketë internet. Unë ju garantoj se në 4 vitet që vijnë, do të ketë zhvillime shumë më të mëdha për moshën dixhitale. Në 4 vitet që vijnë, qeveria do të bëjë çdo përpjekje që nxënësit të kenë kompjuter dhe internet edhe në shtëpitë e tyre.

Në vitin 2005, ne premtuam se do të hapim dyert e universiteteve tona. Shqipëria sot, ka 115 mijë studentë, kundrejt 52 mijë që kishte në vitin 2005. Unë ju jap fjalën se në vitin 2013 Shqipëria do të ketë 160 mijë studentë. Asgjë nuk do të mund të ndalë hovin tonë drejt arsimit, edukimit dhe shkollimit. Në qoftë se në këto 4 vite buxheti u dyfishua, në 4 vitet e ardhshme do të jetë 2 herë më i lartë se ky që është sot.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10768>

10/04/2009

Kryeministri Berisha tha se një ndër objektivat ka qenë ulja e numrit të nxënësve në klasa dhe ky objektivi po realizohet, kur sot numri i nxënësve në klasa është 25-35 nxënës. Ndërkohë, Kryeministri shprehu keqardhjen që ky objektivi nuk po gjen realizim në Tiranë.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10769>

10/04/2009

Kryeministri tha se në katër vitet e ardhshme, përpjekjet do të përqëndrohen në hapjen ndaj sektorit privat në arsim, në mënyrë që ky sektor të angazhojë sa më shumë fonde, duke e çuar kontributin në arsim deri në 8 për qind të PBB-së dhe të mund të shumëfishohet financimi për arsimin.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10770>

11/04/2009

Brenda dy muajve ne do të fillojmë rrugën tjetër, Qafë Plloçë- Qukës, e cila e afron shumë Elbasanin, qytetin që tradicionalisht pushon në Pogradec

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10771>

11/04/2009

Çdo i ri apo e re që fiton të drejtën për të ndjekur studimet në 1 nga 10 universitetet më të mira të planetit, atij do t'i jepet bursë nga qeveria shqiptare.

Unë do të bëjë çdo përpjekje që çdo i ri që kërkon punë të mund të punësohet. Unë do të bëj çdo përpjekje që çdo i ri që krijon familje të ketë mundësi të krijojë strehën e vet.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10773>

13/04/2009

“Ne, - u shpreh Kryeministri - gjetëm një pension në fshat 34 mijë lekë dhe ky pension do të dyfishohet më 1 maj të këtij viti. Ne që ju premtuam se do të dyfishonim pensionet tuaja dhe po e bëjmë këtë realitet, ne ju premtojmë se mandatin e ardhshëm, në fshatrat e Shqipërisë nuk do të ketë pension nën 100 dollarë.”

Ju jap fjalën se në 4 vitet që vijnë do të 5-fishoj rënjët e ullirit në Shqipëri. Në 4 vitet që vijnë, do të investojmë për bujqësinë shqiptarë më shumë se në 70 vitet që shkuan.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10777>

13/04/2009

Sot jam para jush për të informuar qytetarët shqiptarë se qeveria ka përfunduar përllogaritjen e plotë të rritjes së rrogave dhe pensioneve më datën 1 maj. Në përputhje me këto përllogaritje, rroga mesatare e punonjësve të administratës, në katër vite, rritet me 68 %, ndërkohë që dyfishohen rrogat e ulëta, dyfishohen rrogat e infermierëve dhe ato të mësuesve

Kështu, diferenca midis rrogës minimale dhe rrogës mesatare në administratën publike zbrit në 1 me 5, raport ky që ka qenë 1 me 10 katër vite më parë.

Në datën 1 maj dyfishohen pensionet në fshat. Pra, pensionisti që ka marrë 34 mijë lekë të vjetra, në datën 1 maj do të marrë 68 mijë lekë të vjetra, madje edhe pak më shumë. Të ardhurat pensionale minimale në qytet

aktualisht janë 110 mijë lekë dhe shkojnë në 122 mijë lekë. Rritje të ndjeshme pësojnë edhe të gjitha llojet e pensioneve të tjera.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10778>

14/04/2009

Në shkollën tuaj, në çdo shkollë të Durrësit dhe në çdo shkollë të Shqipërisë brenda muajit maj mbi 600 mijë fëmijë shqiptarë që ndjekin shkollat do të mund të lundrojnë në internet.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10780>

14/04/2009

Kryeministri Berisha u shpreh se “pas hapi të parë,që ishte pajisja e shkollave me kabinete informatike, hapi i dytë do të jetë përhapja e mënyrës së të mësuarit e-learning apo mësimi dixhital.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10782>

15/04/2009

Qeveria miratoi sot projektligjin për sistemin e taksave vendore, që vendos kufizimin deri në 10 për qind të taksës të biznesit të vogël.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10787>

16/04/2009

Kryeministri siguroi se pas këtij segmenti rrugor, do të fillojë ndërtimi i rrugës Baldushk- Papër dhe në këtë mënyrë kompletohet një aks i ri rrugor midis Tiranës dhe Elbasanit.

Kryeministri u ndal në premtimin e mbajtur të qeverisë për dyfishimin e pensioneve në fshat, duke siguruar se ky është vetëm hapi i parë, pasi hapi i dytë i madh do të jetë barazimi i pensioneve të fshatit me pensionet në qytet.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10800>

24/04/2009

Po punohet për nxitjen e sektorit privat në arsim, është bërë e mundur shtrirja e internetit në çdo shkollë dhe qeveria do të vazhdojë të përmbushë politikën e saj të shtrirjes së internetit edhe në çdo shtëpi. Kryeministri tha gjithashtu se, në katër vjet është dyfishuar numri i studentëve në vend.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10854>

25/04/2009

“Kjo qeveri ia doli të nxjerrë nga skamja e varfëria, para së gjithash, duke rritur pagat e pensionet dhe duke krijuar vende të reja pune, jo 10-20 apo 60mijë, por 200 mijë shqiptarë. Unë ju garantoj se me këto investime që kemi bërë, në 4 vitet që vijnë, jo 200 mijë, por, do t'i nxjerrim nga varfëria, së paku, edhe 300 mijë që kanë mbetur,” u shpreh Kryeministri.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10858>

25/04/2009

Ndërsa për ata që aplikojnë në 10 universitetet më të mira të perëndimit dhe fitojnë të drejtën e studimit, do të kenë bursën e qeverisë, përfshi këtu rreth 100 mijë dollarë në vit.

Plani ynë është që asnjë fëmijë analfabet në Shqipëri dhe ju garantoj se, sado që të kushtojë, ne jemi të gatshëm ta përballojmë. Së dyti, çdo fëmijë që mbaron klasën e 9-të të mund të vazhdojë gjimnazin, pavarësisht se ku banon ai

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10859>

26/04/2009

Dua t'i garantoj banorët se çdo fshat do të ketë ujësjellësin e tij dhe se në 4 vitet që vijnë, çdo familje shqiptare do të ketë ujin brenda shtëpisë së tij. Ne jemi të vendosur për urbanizimin e plotë të fshatit shqiptar, jemi të vendosur të ndërtojmë rrugë, ujësjellës, kanalizime, shkolla moderne, shërbime sociale, në mënyrë që ju dhe fëmijët tuaj të keni kushte të qytetëruara jetese në vendin ku ju jetoni.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10861>

27/04/2009

Kryeministri njoftoi rritjen e pagave dhe pensioneve, sipas kategorive dhe konkretisht:

- Paga në sektorin e shëndetësisë, mjekë dhe infermiere, dyfishohet.
- Paga mesatare për rreth 104 mijë punonjës buxhetorë, nga 273 mijë lekë që ishte në pranverën e vitit 2005, kalon në 459 mijë lekë në muaj, ose 68 përqind më e lartë. Pagat e zyrtarëve të lartë nuk rriten, por mbeten ato që janë. Duke arritur një pagë të tillë mesatare, - u shpreh Kryeministri - ne kalojmë qartësisht me mbi 30 përqind pagën mesatare të dy vendeve anëtare të BE-së dhe barazohemi me tre vendeve të tjera, natyrisht bëhet fjalë për vende ish komuniste.
- Paga e mësuesve të arsimit parauniversitar nga një pagë prej rreth 230 mijë lekë kalon në rreth 460 mijë lekë, pra, 100 përqind më e lartë se në vitin 2005.
- Paga e punonjësve të infermierisë nga një pagë prej 150 mijë lekë kalon në 310 mijë lekë, pra, 100 përqind më e lartë se në vitin 2005. Paga mesatare për mjekët rritet nga 226 mijë lekë në 470 mijë lekë në muaj, ose 108 përqind.
- Paga minimale në administratën publike shkon në dyfishim.
- Të ardhurat pensionale, duke mos llogaritur këtu 50 mijë lekëshin në fund vitit, rriten nga 49 përqind, sipas llojit të pensioneve, në 135 përqind. Kjo përbën rritjen më të madhe e të pakrahasueshme se çdo kohë dhe vend tjetër.
- Të ardhurat pensionale minimale në qytet rriten nga 83500 mijë lekë në 12400 mijë lekë, rriten me rreth 49 përqind.
- Të ardhurat pensioneve minimale në fshat rriten në masën 100 për qind. Pensionet maksimale në fshat rriten në masën 70 përqind.
- Të ardhurat pensionale maksimale në qytet rriten në masën 30 përqind.
- Pensionet e pleqërisë në qytet kapin një rritje prej 42 përqind.
- Pensionet e invaliditetit rriten me 54 përqind.
- Pensionet mesatare familjare në qytet janë rritur me 54 përqind.
- Pensionet mesatare të pleqërisë në fshat janë rritur me rreth 80 përqind.
- Pensionet mesatare të invaliditetit në fshat janë rritur me 107 përqind.
- Pensionet mesatare familjare në fshat janë rritur me 127.4 përqind.
- Të ardhurat pensionale mesatare të pleqërisë në qytet rriten me 51 përqind.
- Të ardhurat pensionale mesatare të invaliditetit në qytet rriten me 59 përqind.
- Të ardhurat pensionale mesatare familjare në qytet rriten me 55 përqind.
- Të ardhurat pensionale mesatare të pleqërisë në fshat rriten me 95 përqind.
- Të ardhurat pensionale mesatare të invaliditetit në fshat rriten me 123 përqind.
- Të ardhurat pensionale mesatare familjare në fshat rriten me 135 përqind.

Kryeministri qartësoi se këtu nuk është përfshirë një rritje që shtrihet në të gjithë muajt, që për fshatin shkon 10 përqind dhe qytetin 5 për qind, të cilën e kemi quajtur 'kartolina e vitit të ri' dhe me të zerohet e tërë rritja e çmimeve. Kjo rritje, tha Kryeministri, është rritje neto e pensioneve.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10864>

27/04/2009

“Në rast se e lexuat studimin mbi varfërinë në Shqipërisë, varfëria ekstreme nga 3.6, kishte zbritur në 1.7, më shumë se përgjysmuar. Por kjo duhet të shkojë në zero dhe unë i garantoj edhe këtë 1.7 përqind të qytetarëve se ndërhyrje e shpejtë e fuqishme do të bëhet që ata ta harrojnë situatën që kanë përjetuar dhe të kenë një jetë pa dhimbje, siç e meritojnë,” u shpreh Kryeministri, duke garantuar se “jo me fjalë, por me vepra dhe vendime të tilla, qeveria do të bëjë që në mandatin e dytë as edhe një qytetar shqiptar të mos njohë varfërinë ekstreme, do të bëjë që të dalin nga varfëria, qoftë edhe me këtë veprim direkt në portofolin e tyre, edhe ata shqiptarë që, sërish, janë në varfëri.”

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10865>

29/04/2009

Si dhe për projektet për shfrytëzimin e potencialeve të mëdha që ka Shqipëria, si dhe për synimin e qeverisë për ta kthyer vendin në një superfuqi të vogël energjetike në rajon, duke shfrytëzuar këto potenciale dhe pozicionin gjeografik të Shqipërisë.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10903>

02/05/2009

Po ecën me shpejtësi rruga Kardhiq-Delvinë. Ju jap fjalën se shumë shpejt do të fillojë boshti i jugut që do ta sjellë Sarandën në një distancë shumë më të shkurtër me Tiranën.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10916>

04/05/2009

Vlora nga sot do të fillojë të ndërtojë parkun industrial. Vlora ka sot burimin e vet energjetik. Vlora do të ketë njërin prej porteve më të mëdha të Mesdheut. Vlora do të ketë aeroportin e vet, ndaj dhe ju do të ndiheni gjithnjë e më shumë si të rinj e të reja, qytetarë të metropolit të vërtetë europian.

Sot, ne kemi dyfishuar buxhetin për arsimin dhe unë ju garantoj se do ta trefishojmë atë, në katër vitet që vijnë. Internet dhe kompjuter për çdo të ri shqiptar, është premtimi im për ju.

Liberalizimi i vizave brenda vitit të parë, të mandatit tonë të dytë është objektivi ynë, është premtimi ynë dhe ne do ta mbajmë atë.

Vlora së shpejti do të nisë punimet për njërin prej porteve më të mëdha të Mesdheut, port i cili punëson jo më pak se 50 mijë qytetarë të Vlorës dhe të mbarë Shqipërisë.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10921>

05/05/2009

Në këto 4 vite, ne angazhohemi që të sjellim ujën e pijshëm brenda shtëpisë së çdo shqiptare. Në këto 4 vite, ne angazhohemi që me sistemin e kanalizimeve të realizojmë pastrimin e plotë e përfundimtar të ujërave tona. Këto 4 vite, ne zotohemi të shndërrojmë Shqipërinë në një eksportues të rëndësishëm të energjisë elektrike në rajon dhe më gjerë. Në këto 4 vite, ne zotohemi të rindërtojmë apo ndërtojmë nga e para çdo shkollë të vjetër në Shqipëri. Në 4 vitet që vijnë, ne mbetemi të vendosur të vazhdojmë me shpejtësi rritjen e pagave dhe të pensioneve tuaja.

Punësimi juaj do të jetë një nga objektivat më madhore të qeverisë. Gjatë këtij mandati, ne kemi punësuar rreth 80 mijë qytetarë shqiptarë. Unë ju premtoj se në mandatin e dytë do të punësojmë dyfishin e tyre.

Lufta kundër varfërisë është një objektiv tjetër madhor. Në 4 vjet, ne nxorëm nga varfëria 200 mijë shqiptarë. Vetëm gjatë muajit maj, me dyfishimin e pensioneve në fshat, ne bëjmë që edhe 180 mijë qytetarë të tjerë, ndër të cilët 170 mijë në fshat dhe mbi 10 mijë pensionistë me pensione të ndryshme në qytet, të marrin mbi 2 dollarë në ditë, pra, të dalin nga varfëria. Kështu, në 4 vite, ne, së bashku, nxorëm nga kthetrat e varfërisë rreth 400 mijë shqiptarë. Unë ju premtoj që në 4 vitet që vijnë do t'i japim varfërisë goditjen më të pamëshirshme. Zero tolerancë ndaj varfërisë dhe mjerimit në Shqipëri.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10923>

06/05/2009

Duke iu referuar garës normale midis tregut të lirë dhe sektorit publik në këtë drejtim, Kryeministri tha se tregu ecën me një shpejtësi të pa kapshme. “Ne tani po bëjmë studimin e të gjithë territorit, në mënyrë që në orientimet tona të jetë gjithçka e bazuar, por ndërkohë tregu ka mbjellë 2 milionë rrënjë ullinj. Ndjaj më duhet të deklaroj këtu se, pas zgjedhjeve, shifra 20 milionë rrënjë ullinj, që dikur dukej shumë e largët, mund të pësojë një rishqyrtim për rritje të mëtejshme”, theksoi Kryeministri.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10934>

07/05/2009

Unë kam kënaqësi të madhe se në përputhje me premtimin tonë se nga fundi i vitit 2007 e tutje territ do t'i themi lamtumirë, ju jap fjalën se sa të jetë në fuqi qeveria ime nuk do të ketë ndërprerje të energjisë elektrike për mungesë të saj

Ne, që zgjidhëm në mënyrë përfundimtare problemin e energjisë, në mënyrë po kaq përfundimtare do të zgjidhim problemin e ujit. Çdo familje shqiptare do të kenë ujë në shtëpinë e saj dhe ky është zotimi ynë, të cilin ashtu siç e bëmë realitet për shkollat, siç e bëmë realitet për energjinë, absolutisht do të bëjmë realitet për çdo familje shqiptare edhe ujin. Dritat dhe uji janë dy kushtet më themelore.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10992>

09/05/2009

Në mandatin e dytë ne do t'i japim Shqipërisë rrjetin rrugor më të ri dhe më modern në Europë. Në mandatin e dytë ne do të ndërtojmë boshtin e jugut, që kalon nëpër trevën tuaj dhe që afron Sarandën me Tiranën.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11004>

11/05/2009

Vetëm në këta katër muaj, nga iniciativa dhe nxitja e qeverisë, në Shqipëri janë mbjellë 2 milionë rrënjë ullinj. Ne jemi zotuar se në 4 vitet e ardhshme do të financojmë mbjelljen e 20 milionë rrënjë ullinj. Le të punojmë së bashku për ta tejkaluar këtë shifër.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11005>

11/05/2009

Kryeministri Berisha: Pas internetit në shkolla, hapi tjetër i madh do të jetë interneti në çdo shtëpi

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11007>

13/05/2009

Sepse në qoftë se do ta shndërrojmë së shpejti në realitet Portin gjigand të Vlorës, me një investim prej rreth 2 miliard euro, kjo erdhi vetëm e vetëm nga korridori i shqiptarëve, erdhi sepse ky korridor u jep vlerë të dhjetëfish të ujërave të Vlorës

Rrugët do të jenë përparësia absolute infrastrukturore e jona. Në këtë mandat ne do të përfundojmë këtë trajektore, do të përfundojmë boshthin e Jugut. Ne do të lidhim me rrugë të re Elbasanin me Tiranën. Në këtë mandat ne do të lidhim Qafë Pllaçën me Qukësin me rrugë të re. Në këtë mandat, ne do të përfundojmë rrugën e Arbrit.

Unë ju premtoj zonave rurale të Shqipërisë se në mandatin e dytë, në çdo shtëpi në fshat do të ketë ujë të pijshëm, ashtu siç kanë shtëpitë në qytet, do të asfaltojmë rrugët, do të bëjmë që fëmijët e tyre të shkollohen në shkollat e njëjta me ato të qytetit.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11011>

13/05/2009

Duke i shprehur mirënjohje të gjithë sipërmarrësve në Shqipëri, Kryeministri vlerësoi se në rast se gjatë këtyre katër viteve qeveria shkurtoi në administratë rreth 30 për qind të vendeve të punës, bizneset punësuan rreth 80 mijë punonjës të përhershëm në sipërmarrjet e tyre. “Premtimi dhe zotim im është që gjatë katër viteve që vijmë ky numër të 2 – fishohet”, u shpreh Kryeministri Berisha.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11012>

13/05/2009

Gjatë mbledhjes së sotme, Këshilli i Ministrave miratoi një vendim për të ulur tarifën e pagesës për përdorimin e kullotave shtetërore nga blektorët shqiptarë, nga 300 në 100 lekë.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11013>

13/05/2009

“Kjo listë është zgjeruar në mënyrë të ndjeshme me rreth 70 artikuj të rinj, në sajë të performancës së mirë financiare, menaxhimit shumë më të mirë të fondeve të përcaktuara për rimbursimin e barnave, të një transparence të përgjithshme më të madhe në tregun farmaceutik”, u shpreh Kryeministri.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11015>

13/05/2009

Qeveria miratoi sot vendimin për pagën minimale në shkallë vendi, e cila rritet nga 170 në 180 mijë lekë. Kryeministri vlerësoi këtë vendim si shumë të rëndësishëm, duke theksuar se kjo është paga minimale në shkallë vendi, pasi paga në sektorin publik është më e lartë.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11016>

13/05/2009

Kryeministri theksoi se qeveria do të vazhdojë me programin e rimbursimit e granteve për bujqësinë, sepse ky program po jep efekte të shkëlqyera, krahasuar me akcizën e famshme.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11017>

13/05/2009

“Sot ne vendosim dhënie totalisht falas të teksteve shkollore për arsimin parauniversitar, për të gjitha familjet në ndihmë ekonomike. Shteti qëndron në anën e fëmijëve, pasi nuk mund të lejojë që ai qytetar që ka vështirësi të paguajë shumën e rimbursimit, ta lërë fëmijën e tij pa tekste dhe pa shkollë”, tha Kryeministri.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11018>

13/05/2009

Qeveria ul në 1 euro tarifën e përdorimit të ujërave të brendshme dhe detare për rritjen e peshkut. Ky vendim synon që të rrisë investimet në fushën e akuakulturës dhe rritjes së peshkut, si një fushë e rëndësishme në shërbim të shfrytëzimit të ujërave.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11047>

14/05/2009

Kryeministri Berisha mori pjesë dje pasdite, në përrurimin e fillimit të ndërtimit të parkut energjetik në Lezhë, me ndërtimin e centralit me biomasë të lëngshme (vajra vegjetalë) për prodhimin e energjisë elektrike, me kapacitet 140 MW. Ky projekt është një investim i grupit italian “Marseglia”, prej 1.1 miliard euro.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11048>

16/05/2009

Unë jam sot këtu për t’ju premtuar se shtrirja e internetit, në 4 vitet që vijnë, nga shkollat do të kalojë në çdo shtëpi.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11056>

18/05/2009

Edhe një herë i kërkoj Kryetarit të Bashkisë së Tiranës të dorëzojë projektin e unazës së madhe të qytetit dhe ne jemi të gatshëm ta përfundojmë atë, brenda një viti.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11062>

28/05/2009

Këshilli i Ministrave miraton fondin për shpërblimin prej 5 000 lekë për çdo lindje të fëmijëve. Domsdoshmëria e paraqitjes dhe e miratimit të këtij vendimi rrjedh nga detyrimi i zbatimit të dispozitave të ndryshuara ligjore, në bazë të të cilave parashikohet shpërblimi në masën 5 mijë lekë (pesë mijë), për lindjet brenda vendit, të deklaruara brenda 60 ditësh dhe për lindjet jashtë vendit, të deklaruara brenda 90 ditëve.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11087>

29/05/2009

Premtimi ynë solemn është se do të asfaltojmë çdo pëllëmbë rrugë tuajën. Premtimin tonë, ne e bazojmë në ato që kemi arritur. Ne kemi asfaltuar 6000 km rrugë. Tani nuk ka forcë në botë që na mban ne, pa veshur çdo rrugë të këtij vendi me asfalt. Ne vijmë këtu për tu zotuar, se do të pesëfishojmë grantin për prodhimet tuaja dhe se do të bëjmë çdo gjë për rritjen maksimale të prodhimit.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11140>

29/05/2009

Jam këtu për tu premtuar juve jo dyfishimin e grantit të prodhimeve tuaja, por së paku pesëfishimin të tij, në katër vitet që vijnë. Premtimet tona nuk janë premtime të lehta dhe të thjeshta, por me fjalën e nderit janë njëqind për qind të realizueshme.

Ne që asfaltuam në katër vite rreth 6000 km rrugë, në rast se kanë mbetur, në 4 vite do të asfaltojmë dhe 12 mijë të tjera po të kishte. Ne ndërtoam në katër vite 1012 shkolla dhe do të ndërtojmë dhe rindërtojmë çdo shkollë, në çdo cep të këtij vendi.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11141>

29/05/2009

Në katër vitet që vijnë qeveria ime do të bëjë që të gjitha importet, nafta, plehrat, të marrin rimbursimin me skemën anti korrupsion. Pra dua t'ju bëj të ditur se qeveria do të pesëfishojë grantin për ju dhe është e gatshme, me praktika jokorruptive, që ta rrisë atë edhe më tej.

Ne kemi investuar në fshatin shqiptar 1.6 miliardë dollar. Unë ju garantoj se në katër vitet që vijnë, do të investojmë edhe 3 herë më shumë me projektet tona.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11143>

29/05/2009

Në katër vite ne punësuam 80 mijë qytetarë, por në katër vitet që vijnë ne do të punësojmë mbi 160 mijë qytetarë.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11144>

30/05/2009

Ne ju kemi faktuar, dhe do t'ju faktojmë, më shumë mbështetje për prodhimet tuaja, përveç grantit, të cilin ne do ta pesëfishojmë, përveç projektit të ullirit, i cili është më i madhi i ndërmarr në bujqësi ndonjëherë, ne do ju garantojmë vaditjen, të cilën ju do ta menaxhoni me komunën dhe me veten tuaj. Në ju garantojmë kullimin, por ne do të kalojmë në një etapë të dytë. Etapa e re subvencioni për ju edhe i inuteve edhe i naftës.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11145>

30/05/2009

Për ne, për qeverinë time, subvencioni i inuteve dhe i naftës, nuk është një subvencioni pamundur financiar, është plotësisht i mundur. Por në këtë mes ka vetëm një problem tjetër, dhe ne do të ulemi që t'ia gjejmë bashkërisht zgjidhjen.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11146>

01/06/2009

Tirana do të jetë në katër vite kryeqyteti me unazën më moderne dhe më të re në Europë, i unazës së madhe dhe korridoreve të saj.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11150>

02/06/2009

Kryeministri shprehet se qeveria do të mbështesë financimin projektit për ndërtimin dhe sistemimin e tregut çam

Taksa e tabelës për bizneset do të përcaktohet me ligj dhe do të jetë vetëm 1 euro.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11153>

03/06/2009

Në strategjinë e qeverisë time për të shndërruar Shqipërinë në një superfuqi energjetike rajonale, ky është një diamant i vërtetë.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11155>

04/06/2009

“Një thinj-tank shumë i njohur londinez, tha Kryeministri - në vitin 2006 deklaronte se mesatarja e investimeve të huaja në Shqipëri për 10 vitet e fundit ka qenë 70 milion euro, ndërsa vitin e kaluar, investimet në Shqipëri kanë qenë mbi 800 milion euro dhe në katër vitet që vijnë do të jenë mbi 8 miliard euro.”

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11158>

05/06/2009

Në rast se ne në katër vite ndërtojmë 720 ujësjellës, një ndër të cilët është edhe ky që inaugurojmë sot, ju garantoj ju se në katër vitet që vijnë nuk do të ketë familje shqiptare që të mos ketë ujë 24 orë.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11161>

05/06/2009

Boshti i jugut është kryeprojekti i katër viteve që vijnë. Unë jam këtu për t'u zotuar se në këtë rreth vend do të asfaltojmë çdo rrugë për ju, kudo që ndodheni, nga Tomori në Shpirag dhe në të gjitha zonat e tjera.

Së shpejti, ju do të keni universitetin tuaj (Berat), që do të ketë mbështetjen maksimale të qeverisë, në mënyrë që ai të shndërrohet në një epiqendër të madhe të dijes, shkencës dhe studimit.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11163>

06/06/2009

Shqipëria në punë është dhe do të mbetet motoja jonë. Për të nxitur punësimin në zonat e varfra të vendit, qeveria ime do të heqë taksat për bizneset për 5 vjet. Për të nxitur punësimin në mbarë, qeveria ime do të marrë përsipër të gjitha shpenzimet për kualifikimin, trajnimin dhe rikualifikimin e punëtorëve, do të paguajë për ta primin dhe sigurimet shoqërore.

Rrogzhina do të nisë së shpejti by pass-in e saj, sikundër investime të mëdha do të bëhen në të gjithë infrastrukturën e qytetit dhe të fshatrave përreth.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11165>

06/06/2009

Industria e naftës, është industria e perspektivës së këtij vendi. Në katër vite ne e rritëm prodhimin e naftës me 50%. Në katër vitet që vijnë unë ju garantoj se ai do të dyfishohet.

qeveria ime do të financojë çdo projekt të tyre për nxitjen e prodhimit, se qeveria ime do të vendos tokat e tyre nën ujë, kudo që ato ndodhen, se qeveria ime do të ndërtojë dhe rindërtojë sistemin më modern të vadiqjes, në katër vitet që vijnë do të shumëfishojë grantin për fermerët shqiptarë. Ajo do të subvencionojë të gjitha inputet për të gjitha sipërfaqet e mbjella prej tyre, në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Projekti i ullirit është një projekt tjetër i shekullit, të gjithë sëbashku do ta veshim Shqipërinë me ullishte. Në katër vitet që vijnë, do të mbjellim mbi 5 milion rrënjë ullinj në këtë vend. Ne do të krijojmë kushte për dhjetëra milion të tjera në vitet që do të vijnë.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11166>

08/06/2009

Kemi dyfishuar pensionet e të gjithë fermerëve në Shqipëri, por sot zotohem para mirditorëve se do shkurtoj pesë vite pensionin e minatorëve dhe me efekt prapaveprues.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11171>

08/06/2009

Kam ardhur sot për t'ju premtuar ju se në katër vitet që vijnë rrogat tuaja, pensionet tuaja do të jenë dy herë më të madhe, sesa të gjashtë vendeve anëtare të Bashkimit Europian.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11172>

09/06/2009

Unë ju garantoj se shumë shpejt të gjitha blerjet e kësaj qeverie, edhe ato të vogla, të gjitha ankandet do të zhvillohen në mënyrë elektronike. Transparencë e plotë.

Ju siguroj se së shpejti do të krijojmë Qendrën Kombëtare, sportelin unik për energjinë. Në mënyrë që ju të mos rendni javë e muaj të tëra pas kësaj apo asaj lejeje, ju siguroj se parimi 'heshtja është miratim' do të tejshkojë të gjithë veprimtarinë e kësaj administrate. E nisëm me lejet e ndërtimit dhe këtë jo si një akt kundërshtie apo karshillëku ndaj kryetarit të bashkisë së Tiranës. Jo, por sepse praktikat e tij janë unike në botë.

duhet Gjykata, duhen gjykatësit që t'i vënë 'kufirin tek thana' qeverisë dhe burokratit. Ne bëmë ligjin më të mirë të mundshëm dhe ai do të kalojë. Unë ju garantoj se ligji i parë që do të kalojë në mandatin e ardhshëm do të jetë ligji i Gjykatës Administrative.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11175>

09/06/2009

Në hidrocentralet, në të gjithë Shqipërinë do të punësohen mbi 60 mijë qytetarë. Në rrugët, në infrastrukturën, në turizmit, në parqet industriale do të punësohen dhjetëra e mijëra qytetarë.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11176>

09/06/2009

Fermerëve të Peqinit unë u premtoj: së pari, financimin e çdo projekti të tyre për rritjen e prodhimit. Së dyti, subvencionimin e naftës dhe importeve të tjera për të gjitha sipërfaqet e mbjella. Së treti, rindërtimin e plotë të sistemeve të vaditjes. Së katërti, ju premtoj investime në agrobiznes dhe nxitje të përpunimit të prodhimeve të tyre. Ju premtoj pensione të barabarta me pensionet e qytetit. Ky është zotimi ynë!

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11177>

11/06/2009

Përbashkët me bashkitë dhe komunat e vendit, dhe mbetet e paprekur. Pra përveç kësaj takse i qytetarët që do të legalizojnë objektet do të kenë të drejtë që 80 % të vlerës ta paguajnë me letra me vlerë.”

Kryeministri theksoi se në këtë mënyrë hapet për letrat me vlerë një nga tregjet më të fuqishëm të vendit, i cili bazohet në legalizimin e 500 mijë objekteve “Në këtë mënyrë ne hapim një treg ekzakt së 4 deri në 6 herë më të madhe sesa vlera e letrave me vlerë.”

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11183>

11/06/2009

Edhe njëherë dua tu rikthehem pronës dhe pronarëve. Duke njohur vështirësitë shumë serioze të këtij procesi një gjë duhet ti garantoj pronarëve të këtij vendi se unë personalisht dhe qeveria ime, aktualja dhe ajo që do të vijë me votën e lirë të shqiptarëve nuk do të përdorë ndonjëherë vlerë tjetër përveç vlerës së tregut për kompensimin monetar apo fizik të tyre.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11184>

11/06/2009

Në mbledhjen e sotme të Këshillit të Ministrave u miratua vendimi “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje” duke e ulur atë sipas kategorive nga 2-4 herë.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11185>

11/06/2009

Kryeministri Berisha u shpreh se brenda katër viteve nuk do të ketë më asnjë qytetar shqiptar nën nivelin e 2 dollarëve në ditë.

Rritja që barazon të ardhurën nga papunësia me 50 % të pagës minimale në shkallë vendi, bëhet në kuadër të përshtatjes së legjislacionit shqiptar me atë ndërkombëtar. Kryeministri Berisha u shpreh se brenda katër viteve nuk do të ketë më asnjë qytetar shqiptar nën nivelin e 2 dollarëve në ditë.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11186>

11/06/2009

Qeveria miratoi sot vendimin për rritjen e pagesës mujore të personave me statusin e të verbrit.

Ky vendim rrit pagesën për personat që kanë statusin e të verbrit dhe të kujdestarëve të tyre nga 8700 lekë në muaj që është aktualisht në 9800 lekë në muaj.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11188>

11/06/2009

Së shpejti do inaugurojmë Velipojë-Ulqin, së shpejti rrugën Koman-Fierzë, së shpejti Bypass e Shkodrës dhe unazën e liqenit tuaj madhështor, do ta bëjmë unazën më të bukur, që do llamburitë ditë e natë nga dritat.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11261>

12/06/2009

Projekti i dytë i madh për Maliqin dhe Korçën është autostrada Qafë Pllaçë - Qukës, e cila do të përfundojë në fund të vitit 2010. Ju, por edhe të gjithë shqiptarët do ta kenë Shqipërinë në pëllëmbë të dorës. Ju do të mbërrini në kryeqytet në një kohë dy herë më shkurtër se sa tani. Përveç kësaj, do të jetë edhe autostrada e re Elbasan – Tiranë.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11271>

12/06/2009

Unë kërkoj votën tuaj, në mënyrë që rrogat dhe pensionet tuaja të cilat sot janë 30% më të larta se në dy vende anëtare të Bashkimit Europian, në katër vitet që vijnë të jenë më të larta se 6 vende anëtare të Bashkimit Europian. Ju i meritoni plotësisht ato dhe unë zotohem përpara jush për to.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11272>

13/06/2009

Unë jam gati dhe kërkoj mirëkuptimin tuaj për këtë: më kërkonin rritje pensionesh por jo statuse, sepse statutet nuk shkojnë me pensionet dhe unë do t'ju rris pensionet tuaja. Por reforma evropiane e pensioneve nuk lejon statutet brenda saj, lejon rritje pensionesh dhe ne do t'ua rrisim ato, lejohet ulja e moshës dhe unë do të ul moshën e pensionit.

Unë i garantoj gjithë pensionistët shqiptarë, se në katër vitet që vijnë, pensionet e tyre do të jenë më të mëdha se pensionet e qytetarëve të 6 vendeve anëtarë të Bashkimit Europian.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11273>

13/06/2009

Katër vitet që vijnë, Paskuqani do të shndërrohet në një nga zonat më të kushtueshme të vendit. Legalizimi po ecën. Para dy ditësh vendosa të hap tregun e letrave me vlerë. Hapja e tregut të letrave me vlerë është interesi i 800 mijë shqiptarëve, që i kanë marrë ato dhe që pas rebelimit u përpoqën t'ua shndërrojnë në letra pa vlerë. Tani ato bëhen letra me vlerë. Tregu i letrave me vlerë ndihmon edhe të gjithë banorët, të gjithë qytetarët që legalizimet t'i bëjnë me një çmim edhe më të arsyeshëm.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11275>

16/06/2009

Kam ardhur sot këtu tu jap fjalën ish minatorëve të kësaj qyteze se do të shkurtojmë me 5 vite moshën e pensionit të tyre dhe kjo do të ketë efekt prapaveprues, për pensionet.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11290>

16/06/2009

Objektivi im është që në katër vite mjekët, infermierët dhe laborantët të marrin më shumë se kolegët e tyre të 6 vendeve anëtare të Bashkimit Europian.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11291>

17/06/2009

Ne kemi gati 5.6 miliard euro investime në 104 hidrocentrale, në 6 parqe industriale, në 4 parqe energjetike, janë gati projektet për asfaltimin e të gjitha rrugëve të Shqipërisë, janë gati projektet dhe financimet për të sjellë ujën e pijshëm në çdo familje shqiptare kudo që ndodhet. Dua të garantoj 450 familje, të cilat vuajnë në një situatë të vështirë strehimi se do të ndërtojmë banesa sociale dhe do të zgjidhim përfundimisht problemin e tyre.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11299>

18/06/2009

Në mbledhjen e sotme të Këshillit të Ministrave, Kryeministri Berisha ngarkoi ministrinë përkatëse për të përgatitur vendimin për amendimin e ligjit për pensionet. Ky vendim do të ulë moshën e pensioneve për minatorët me 5 vjet, si dhe do të ketë fuqi prapavepruese, në mënyrë që të mbulojë të gjithë minatorët dhe ish minatorët shqiptarë.

Gjithashtu në bazë të këtij vendimi, pensionet e minatorëve do të ngrihen në nivelin më të lartë të mundshëm për këtë kategori.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11305>

18/06/2009

Janë 6 mijë familje të tjera, kryesisht në Tiranë, banesat e të cilëve legalizohen. Janë rreth 1300 familje, të cilave iu privatizohen banesat në Kombinatat dhe tek ish shkollat e Partisë. E vërteta është që procesi i legalizimit po shkon drejt fazës më të shpejtë, pasi të përgatitura për proces janë mbi 150 mijë objekte

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11306>

18/06/2009

Këshilli i Ministrave miratoi sot vendimin “Për kthimin në fond banesash të disa objekteve të ish-kombinatit të Tekstileve, në Tiranë, të Ndërmarrjes mekanike-tekstili, Tiranë dhe të ish shkollës së Partisë, Tiranë”, në të cilat aktualisht banojnë 195 familje që i përkasin shtresës së ish- të përndjekurve politikë.

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11308>

21/06/2009

Në mandatin e dytë do të ndërtojmë rrugën e re Tiranë - Krujë - Qafë Shtamë

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11354>

*** Linket e premtiveve PD 2009**

<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10652>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10654>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10657>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10680>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10764>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10768>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10769>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10770>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10771>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10773>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10777>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10778>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10780>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10782>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10787>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10800>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10854>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10858>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10859>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10861>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10864>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10865>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10903>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10916>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10921>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10923>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10934>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10992>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11004>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11005>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11007>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11011>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11012>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11013>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11015>
<http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11016>

PS 2009

Burimet e informacionit nga media online dhe deklaratimet publike të lidershit të partisë në fushatën elektorale

8 Janar 2009 (Konferende shtypi. Erjon Brace)

Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste, do të vazhdojë t'ju jap mbështetje 606 punëtorëve të Ballshit për të marrë të gjitha paratë.

9 Janar 2009 (Rama komunikim public pas takimit me shoqaten hidrokarbure)

Rama: Qeveria te zgjidhe me maturi e transparence situaten monopol ne tregun e hidrokarbureve

11 Janar 2009/A.Dade (Deklarate per media)

padyschim do të plotësojë të gjitha angazhimet lidhur me heqjen e barrierave për liberazimin e vizave dhe shqiptarët do të lëvizin me dinjitet dhe do të përfitojnë nga lëvizja e lirë e shtetasve, jo vetëm brenda rajonit, por në mënyrë të veçantë në vendet anëtare të BE, duke afruar njëherazi edhe datën që Shqipëria të jetë vend kandidat për në BE.

12 Janar 2009/Y.Manjani (Deklarate per media)

jemi të sigurtë se me ardhjen në qeverisje PSSH do ta ndryshojmë këtë gjendje krejtësisht. (Rendi dhe siguria)

13 Janar 2009/I.Beqja (Deklarate per media)

Partia Socialiste është e vendosur që kjo sjellje mbytëse ndaj sipërmarrjes, ashtu si dhe pozicionet monopoliste, të marrin fund.

14 janar 2009/M.Ulqini (Deklarate per media)

Së fundmi, ne pas ardhjes në pushtet në qershorin e këtij viti, do të kemi pjesë të axhendës tonë edhe keqpërdorimin e fondeve të taksapaguesve shqiptarë për reklamat dhe spotet qeveritare.

15 Janar 2009/E.Brace (Deklarate per media)

Gërdeci nuk është sot një motivim elektorale, por një energji për të kërkuar ndryshim dhe drejtësi. Por, do të doja t'ju them se deri ditën e fundit kur përpara drejtësisë të shkojnë këta njerëz, nuk do të ketë absolutisht asnjë tërheqje nga kërkesa për drejtësi.

17 Janar 2009/E.Brace (Deklarate per media)

Pronat janë përdorur për korrupsion dhe korrupsioni me pronat, tokat, më së shumti është dominant, duke punësuar pushtetarë të çdo lloj qëndror apo lokal, ata që merren me bujqësinë, po ashtu ata që merren me ndërtimet në fushë apo në mal, në bregdet apo në pyll, tokë shtetërore, publike, e ndërmarrjeve publike, reparteve ushtarake, e pa ndarë apo me pronarë të certifikuar qysh herët.

Ne garantojmë të gjithë shqiptarët, se ndryshimi i pushtetit, rrëzimi i kësaj qeverie të korruptuar dhe anti-popullore me votë, do t'ju jap fund këtyre praktikave korruptive familjare, madje, do të ndëshkojë plotësisht dhe likujdojë në çdo metër katror tokë të lirë.

23 Janar 2009/E.Rama (Deklarate per media)

Ndërsa shqiptarëve e shqiptareve që fyhen e abuzohen përditë nga Televizioni Publik Shqiptar u premtoj se pas 156 ditësh do të marrë fund epoka e Televizionit të Pushtetit dhe do të fillojë epoka e Televizionit të Qytetarëve, do të mbarojë koha e ekranit të paradave të sukseseve qeveritare dhe do të fillojë koha e ekranit të informacionit e të kulturës qytetare, do të pushojë era që fryn nga e shkuara komuniste e Shqipërisë dhe do të nisë të fryjë era e së ardhmes perëndimore të shoqërisë sonë europiane.

24 Janar 2009/Y.manjani (Konferencë për media)

PSSH ka monitoruar në vijimësi qeverinë në procesion e hartimit dhe të miratimit të legjislacionit në vend, në tre vite të plota, 2006, 2007 dhe 2008. Sic kemi denoncuar vazhdimisht në këto vite, **qeveria ka prodhuar legjislacion jo demokratik, jo kushtetues e pa fuqi juridike**. PSSH ka monitoruar dhe do të monitorojë me kujdes deri në ditën e fundit këtë qeveri, me qëllim që të korrektojë dëmet e shkaktuara nga një legjislacion i tillë, dhe ka përgatitur tashmë projektin e saj të kthimit të vendit në normalitet kushtetues e legjislativ.

26 Janar 2009/Rama (Deklaratë për shtyp)

Marrja e masave të menjëhershme për normalizimin e punës në minierat e të gjithë vendit dhe respektimin e kushteve elementare të sigurisë nuk mund të presë ditën e ndryshimit, qershorin që vjen. Masat duhen marrë sot!

29 janar 2009/Brace (Fjala e mbajtur në Kuvend)

duan hetim dhe gjykim të paanshëm e ligjor nga institucionet ligjore në Shqipëri, për vrasjen shtetërore të 26 shqiptarëve të pafajshëm burra e gra, fëmijë, të rritur e foshnje në bark të nënës. Për trafikun marramendës të armëve në mashtrim të plotë të partnerve tanë amerikan, trafiku super të armëve kudo në vende në konflikt apo të klient në listat e zeza të terroristëve. Vjedhje marramendëse në rrugën e kombit, në dy segmente Rrëshen-Kalimash e Kalimash-Kukës-Morinë, të paditura nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe jo vetëm nga opozita. Kërkojmë hetim të ndershëm mbi privatizimin e Albtelekomit, pa proces, por me një kontratë të re. Kërkojmë proces hetimor mbi privatizimin skandaloz të kompanisë ARMO. Kërkojmë proces hetimor mbi privatizimin skandaloz të kompanisë INSIG. Kërkojmë proces hetimi mbi blerjen skandaloze të energjisë nga një kompani enkas e krijuar nga familja e tij në vitin e parë me përfitim prej 36 mln eurosh dhe vitin e dytë me 78 mln euro të tjera. Kërkojmë hetim serioz për aferën marramendëse me tokat në Porto Romano, e cila nuk është më toka e helmuar, por toka e florinjte ku përmes firmave të qeverisë familjare përfitimi arriti në mbi 50 mln dollarë. Kërkojmë hetim serioz për shumën marramendëse të parave të pista apo rryshfeteve të të njëjtit njeri përmes firmash fantazma, pa llogari, pa aktivitet, pa punonjës. Kërkojmë hetim serioz për pasurimin e familjes qeveritare, e cila është në hetim nga inspektorati që nga viti 2006 dhe pa pasur ende një konkluzion një vendim, që trembet prej tre vitesh të bëhet publik pikërisht për këto pasuri. Kërkojmë hetim serioz për të gjithë rrjetin e licencave të fabrikave të çimentos në dyert e Tiranës, kërkojmë hetim serioz për të gjithë rrjetin e licencave të hidrocentraleve dhënë me koncesion pa gara, në më të shumtën e rasteve, duke nisur nga ato mbi lumin Devoll. Kërkojmë hetim serioz për grabitjen masive të tokave nisur nga Kinostudio, pastaj tokat në bregdet në Plazhin e Gjeneralit, në bregun e jugut, aq sa të gjithë tashmë qeverinë tuaj e shikojnë si qeverinë që vazhdon të këndojë këngën "Vamos ala plaja".

31 Janar 2009/Rama (Konferenca Kombëtare e Bujqësisë, Lushnje)

ne mund dhe do ta realizojmë, inventarizimin e plotë të pronës në tërësi dhe të tokës bujqësore në vecanti dhe nga ana tjetër dhënien e certifikatës së pronësisë të çdo shqiptari e shqiptareje që e ka fituar këtë me të drejtën Zotit dhe me forcën e ligjit dhe që për 18 vjet me radhë, nuk ka arritur ta ketë në dorë për shkak të Maliqit të radhës. Nuk mund të kemi dot kapitalizëm pa treg dhe nuk mund të kemi zhvillim të bujqësisë pa

tregun e tokës. Atëherë ne e kemi shumë të qartë atë që duhet të bëjmë, mund ta bëjmë dhe pa dyshim do ta bëjmë.

Ne do ta vendosim menjëherë përfitimin nga barrë lindja për çdo nënë në qytet dhe në fshat sepse ky është një detyrim i të gjithë shoqërisë sonë. Nuk ka asnjë justifikim të mundshëm për asnjë shtet dhe për asnjë qeveri që mund të fshihet pas kontributit të sigurimeve , gjë që sot është e pamundur për shumë e shumë familje që mezi nxjerrin bukën e gojës, e që nuk kanë mundësi të shohin e të mendojnë për të ardhmen sepse nuk arrijnë dot të ngrysin të tashmen.

1 Shkurt 2009/Ervin Bushati (Konferencë për shtyp)

Partia Socialiste është e ndërgjegjshme se sektori bujqësor ka nevojë për politika që të nxisin rritjen e produktivitetit, në mënyrë që ata që figurojnë si të punësuar në këtë sektor të mos jenë të nën-paguar. Gjithashtu, ka nevojë për trajnime dhe shkolla profesionale për të rritur aftësitë dhe produktivitetin e forcës së punës në këtë sektor. Të gjitha këto PSSH do t'i bëjë realitet me programin e saj për bujqësinë e zhvillimin rural.

3 Shkurt 2009/Ilir Beqja (Konferencë për shtyp)

Kur qeverisë së Sali Berishës i kanë mbetur vetëm 145 ditë Partia Socialiste rikonfirmon angazhimin se në programin e saj të ri qeverisë, shqiptarët do të gjejnë instrumentin për t'u ndarë një herë e mirë nga varfëria.

7 Shkurt 2009/Beqja (Konferencë për shtyp)

Vetëm 141 ditë i kanë mbetur qeverisë së Sali Berishës. Ardhja e PS-së në pushtet dhe programi i saj për shëndetësinë do të ofrojnë zgjidhje edhe për parandalimin, edhe për diganostikimin, edhe për kurimin, edhe për rehabilitimin.

7 Shkurt 2009/Rama (Takim me rrjetin e vullnetareve, Patos)

Ne do t'i bëjmë gjimnazet e universitetet tona hapësira të dijes, të konkurrencës e të meritës dhe do të garantojmë investimet e çdo familjeje për nxënësit e studentët jo duke dhënë letra pa vlerë që quhen diploma, po duke i dhënë çdo diplome vlerën e saj. Ne kemi bindjen se arsimimi është politika më e mirë ekonomike dhe në 4 vjet do të bëjmë për arsimimin e fëmijëve e të të rinjve aq sa politika e vjetër nuk ka bërë në 18 vjet.

10 Shkurt 2009/Rama (Takim me rrjetin e vullnetareve, Rrogozhinë)

Ne do t'i japim dinjitet shtetit tonë dhe liri lëvizjeje pa viza e kontrole diskriminuese nëpër kufijtë e Europës të gjithë shtetasve shqiptarë, në rradhë të parë të rinjve e të rejave që sot kanë më pak të drejta daljeje nga vendi ynë se ç'kanë bashkëmoshatarët e tyre koreanoveriorë. Ne kemi bindjen se arsimimi është politika më e mirë ekonomike dhe në 4 vjet do të bëjmë për arsimimin e fëmijëve e të të rinjve aq sa politika e vjetër nuk ka bërë në 18 vjet. Ne do ta mundim parazitizmin e detyruar, duke luftuar kudo e me të gjitha mënyrat me papunësinë dhe s'do të lejojmë që të rejat e të rinjtë të sorrollaten gjithë ditën rrugëve e kafeneve për shkak se s'kanë ku shkojnë, apo të arratisen maleve për në Greqi, apo s'kanë ku punojnë."

12 Shkurt 2009/Rama (Takim me rrjetin e vullnetareve, Lacc)

Brenda 4 vjetësh asnjë qese plastike nuk do të hidhet më në Shqipëri, në plazhe, lumenjtë, rrugët, në parqet, oborret publike, të cilat do të jenë çliruar përfundimisht nga makthi i qeseve që prej 18 vjetësh janë kthyer në lulen – simbol të pushtetit të politikës së vjetër. Ne nuk mund ta respektojmë atdheun

më pak se shtëpinë tonë dhe në Shqipërinë që ne do të qeverisim, pastërtia e të gjithë hapësirës ku jetojmë së bashku, do të jetë arritja jonë e përbashkët.

12 Shkurt 2009/Rama (Takim me rrjetin e vullnetareve, Lezhe)

Ne s'do ta lemë më fshatin shqiptar jashtë listës së punëve të qeverisë, po do ta bëjmë kryefjalë të punës sonë. Nuk mund të ketë një Shqipëri evropiane që jeton në Tiranë dhe një Shqipëri mesjetare që jeton në fshat.

14 Shkurt 2009/Ervin Bushati (conference shtypi)

PSSH me programin e saj të ri për bujqësinë, pas 133 ditësh do të nisë luftën reale me varfërinë në Shqipëri.

15 Shkurt 2009/Ermira Danaj (Konference shtypi)

Rritja e punësimit, sigurimi i një punësimi të denjë dhe përmirësimi i dukshëm i shërbimeve sociale për gratë dhe vajzat shqiptare do të jetë një ndër çështjet kryesore të punës së qeverisë së re vetëm pas 132 ditësh.

18 Shkurt 2009/rama (Takim në KAMEZ)

Qeveria jonë e bashkimit të ri, pa dallim feje, krahinë dhe ideje, do ta përfundojë legalizimin, jo duke u dhënë në dorë një Shaban-tapi, pa asnjë vlerë, por duke ju kthyer pasuritë tuaja të paluajtshme, duke e kthyer në pasurinë tuaj të paluajtshme, shtëpitë, që politikanët për interesa elektorale ua mbajnë peng tash 10 vjet."

Për liderin e opozitës, me fitoren e 28 qershorit, do të fillojë edhe fundi i kaosit në hapësirat informale, ku PS do të investojmë fuqimisht si asnjëherë më parë në të gjitha këto vite, për kanalizime, rrugë, ndriçim, për çerdhe, kopshte e shkolla, dhe do t'i integrojë këto hapësira në kryeqytet dhe në qytetet të tjera, sepse sipas Ramës, nuk mund të ketë një Shqipëri evropiane në Tiranë dhe një Shqipëri mesjetare në Bathore, apo rreth qyteteve të tjera të vendit.

19 Shkurt 2009/Rama (Takim në Gramsh)

Në katër vitet e ardhshme ne do të dyfishojmë buxhetin e shumëfishojmë forcat për zhvillimin e fshatit për rimëkëmbjen e bujqësisë e blegtorisë, për rindërtimin e rrugëve që zhvillojnë ekonominë rurale, për përmirësimin rrënjësor të shërbimit arsimor e shëndetësor në zonat rurale."

20 Shkurt 2009/Rama (Takim me rrjetin e vullnetareve, GRAMSH)

hapur epokën e kapitalizmit në fshat. Ne do ta hapim këtë epokë më 28 qershor duke mbyllur procesin e certifikimit të pronësisë mbi tokën bujqësore mbi bazën e ligji 7501, duke i kthyer bujqit dhe fermerët shqiptarë nga bujkrobër që mbijetojnë pa pronë e mbështetje nga shteti në zotër të tokës që bashkëpunojnë me njëri tjetrin e me shtetin për të nxjerrë nga varfëria familjen e tyre, fshatin e tyre, atdheun e tyre.

Më lejoni t'ju them, se ne, as do ta mbyllim dhe as do ta shndërrojmë Normalen e Elbasanit në një gjimnaz si gjithë të tjerët, por do ta rikthejmë atë në një vatër të edukimit të edukatorëve të fëmijëve tanë, duke i kthyer prestigjin e një historie të nisur 100 vjet më parë.

21 Shkurt 2009/Harasani (Konference per media)

Po përsërisim dhe njëherë që ne si Parti Socialiste jemi pro zhvillimit, pro investimeve të huaja dhe partneritetit shtet – privat, pasi ishim ne që e filluam këtë partneritet me shumë sukses, por do të ngremë zërin tonë fuqishëm ndaj këtyre praktikave korruptive!

Kërkojmë një rishikim të kësaj kontratë duke mbajtur parasysh eliminimin e favorizimeve korruptive dhe mbi të gjitha interesat e popullit shqiptar! (HEC mbi Devoll)

24 Shkurt 2009/Rama (Takim me vullnetaret, Pogradec)

“Ne do ta hapim epokën e re në fshat, më 28 Qershor duke mbyllur procesin e certifikimit të pronësisë mbi tokën bujqësore mbi bazën e ligjit 7501. Duke i kthyer bujqit e fermerët shqiptarë nga bujkrobër që mbijetojnë pa pronë e mbështetje nga shteti në zotër të tokës së tyre.

24 Shkurt 2009/Leskaj (Dekl.shtypi. pas takimit me 3 ministra te Kosoves)

Ne jo vetëm do të përfundojmë rrugën Durrës Kukës, por do e transformojmë rrugën e marrëdhënieve tona politike dhe ekonomike, në një aks strategjik zhvillimi për të mirën e njerëzve tanë e të gjeneratave që vijnë.”

25 Shkurt 2009/Alfred Dalipi (conference per shtyp)

Ne garantojmë se të gjithë ata që po përdorin para publike në kundërshtim me ligjet dhe aktet nënligjore të këtij vendi do të përgjigjen penalisht dhe do të paguajnë civilisht çdo qindarkë që ju vidhet shqiptarëve.

26 Shkurt 2009/Rama (Konference per shtyp)

ne do ta vëmë maxhoranecën e re të 28 qershorit në një marrëdhënie të re me gjyqësorin dhe do të bëjmë gjithshka për të forcuar pavarësinë kushtetuese e financiare të sistemit gjyqësor

ne do të bëjmë me qeverinë tonë të re reforma rrënjësore që do të luftojnë korrupsionin dhe rrisin ndjeshëm cilësinë e shërbimit policor apo të krejt sistemit arsimor.

Qeveria e re do të jetë e qytetarëve, jo e oborrtarëve dhe ne do të bëjmë më në fund inventarizimin e plotë të pronës duke i dhënë fund batërdisë 18 vjeçare të abuzimit me pronën përmes kanaleve të korrupsionit qeveritar.

1 Mars 2009/Ervin Bushati (Konference per shtyp)

Partia Socialiste do të krijojë vende të reja pune: vende pune me kushte njerëzore dhe me paga dinjitoze për familjet shqiptare.

1 Mars 2009/Rama (Takim ne Gjirokastr dhe Permet)

Nuk çuditem aspak që sa herë unë them se ne do t'u japim të gjithë bujqve e fermerëve certifikatën e pronësisë mbi tokën bujqësore, mbi bazën e ligjit 7501, cinikët e Ministrisë së Bujqësisë dalin me vrap për të thënë se kjo punë qenka e mbaruar.

5 Mars 2009/Beqja (Konferencë për shtyp)

Partia Socialiste garanton të gjithë individët dhe sipërmarrjet se me ardhjen e saj në pushtet do të përfundojë sjellja abuzive në administrimin tatimor, do të nxitet vetëdeklarimi, do të ç'instalohet sistemi i referencave, do të garantohet rimbursimi i Tatimit të Vlerës së Shtuar.

6 Mars 2009/Besnik Dervishi (konferencë për shtyp)

28 Qershori dhe qeverisja jonë përveç përfundimit të këtyre segmenteve, por edhe segmenteve të tjerë rrugorë, konform dokumentit të Planit Kombëtar të Transportit të hartuar me ndihmë të BE, do të bëjë të plotë edhe hartën e investimeve para e pas 2005-s, por edhe transparencën e abuzimeve.

7 Mars 2009/Rama ((Prezantim i programit për arsimin, Korce)

“Ajo që do të bëjmë është se do të unifikojmë programet mësimore me një model evropian të përafuar, duke pasur në konsideratë domosdoshmërinë që në të njëjtën kohë të unifikojmë modelin e programeve mësimore me Kosovën. Ne do ta cojmë minimumi 5 % kontributin e buxhetit për arsimin”

8 Mars 2009/Rama (Takim me FGS Tirane)

Unë dua ta përsëris edhe sot, se pas 28 Qershorit, asnjë nënë shqiptare, në asnjë qendër apo periferi të vendit, në asnjë fushë apo mal, nuk do ta lëmë që për shkak të varfërisë, të lërë foshnjën, por do ta mbajmë pranë foshnjës, duke ia mbuluar së bashku përfitimin nga barrëlindja. Ky është minimumi që një shoqëri e vetëdijshme që mund të bëjë. Minimumi që ne do të bëjmë në drejtim të rrugës tonë, për të garantuar mundësi të barabarta, mes të gjithë qytetarëve dhe qytetareve, qofshin burra e qofshin gra, qofshin djem qofshin vajza, qofshin në qytet qofshin në fshat, qofshin në Veri qofshin në Jug, qofshin të rinj apo qofshin të reja.

Dëshiroj të them sot, se ne e konsiderojmë detyrimin tonë, që të bëjmë çdo përpjekje që elementët ekstrem apo elementët e provueshëm të dhunës në familje t'i bëjmë pjesë të krimeve penale. Ky sigurisht një detyrim, që nuk buron nga shpirti i ndëshkimit, por nga ai shpirt drejtësie që karakterizon shumë prej vendeve të zhvilluara, ku dhuna që lidhet me krimin në familje, trajtohet pikërisht përmes kodit të procedurës penale.

Objektivi ynë do të jetë rritja e nivelit të frekuentimit të çerdheve dhe kopshteve në të gjithë vendin deri në 40 %, për grup moshën 0-3 vjeç.

Pa ndryshuar radikalisht në treguesit statistikor të pjesëmarrjes së grave, jo thjesht dhe vetëm në politikë, por në sistemin ekzekutiv të këtij vendi, nuk mund të kemi as një pushtet legjislativ më të vetdijshëm dhe më funksional dhe as një pushtet ekzekutiv më të të vetdijshëm për të garantuar sfidën që kemi përpara.

9 Mars 2009/Rama (deklarate për media)

Shqipëria e shumë plagëve të hapura, në 15 Mars, i kthehet një plage, e cila mund të mbyllet kur të bëhet drejtësi, kur e vërteta të zbardhet plotësisht dhe kur të gjithë përgjegjësit të marrin atë që ju takon. E nga ana tjetër, mund të mbyllet vetëm kur të gjitha familjet e dëmtuara të kthehen në normalitet. Kur e ardhmja e të gjithë jetimëve, të jetë e siguar. Këtë nuk mund ta bëjë askush tjetër përveç shtetit dhe nëpërmjet qeverisë së re, që ne të gjithë së bashku do të ndërtojmë me votën e 28 Qershorit.

20 Mars 2009/Y.Manjani (deklarate për media)

Pakti për drejtësinë që propozuam u refuzuar me arrogancë nga korrupsioni i kësaj qeverie.

Vetëm pas 28 qershorit do të mundësohet një reformë reale në drejtësi. Reforma në drejtësi që kemi projektuar do të jetë përfshirëse dhe më consensus të gjerë public dhe insitucional.

24 Mars 2009/Y.Manjani (Deklarate për media)

Procesi i legalizimeve në Shqipëri është turpi i shtetit të tranzicionit, ku Saliu dhe Shabani përfaqësojnë pjesën më të madhe të fajit.

PSSH mbetet e angazhuar, që ky proces jo vetëm të përfundojë në kohë, por të fillojë procesi i urbanizimit të këtyre zonave duke i bërë ata familje pjesë të qytetit ku kanë zgjedhur të banojnë.

Ky proces do të përfundojë pas 28 Qershorit kur bashkë me turpin për dështimin shtetëror në menaxhimin e këtyre zonave informale të na hiqet edhe pengesa politike që quhet SALI BERISHA.

31 Mars 2009/I.Gjoni (deklarate per media)

Parlamenti shqiptar ka miratuar disa ligje, por Qeveria duke mos fshehur qëndrimin e saj të deklaruar e konfirmuar disa herë, kundër kësaj shtrese, i ka injoruar ato. Kështu, ushtarakët e FA në lirim, në rezervë apo pension pleqërie, kanë ngelur të përbuzur dhe nuk kanë marrë atë që u takon të cilën shoqëria shqiptare ua ka akorduar nëpërmjet legjislacionit përkatës të miratuar në Parlament.

PS garanton të gjithë ushtarakët se pas 28 qershorit do të rivendosë, pa mëdyshjen më të vogël, në vend dinjitetin dhe të drejtat e tyre.

7 Prill 2009/Beqja (deklarate per media)

Pas 82 ditësh ndryshimi do të vijë edhe për shëndetësinë. Shqiptarët do të kenë një sistem shëndetsor të ndershëm, të barabartë, cilësor, të shtrirë në të gjithë vendin. Pas 82 ditësh, bashkë me mjekët e talentuar e të përkushtuar shqiptarë ne do të rindërtojmë shëndetësinë shqiptare. Pas 82 ditësh ne do të rivendosim besimin e tradhëtuar të shqiptarëve për shëndetësinë dhe do të rivendosim dinjitetin e nëpërkëmbur të mjekëve.

11 Prill 2009/L.Shamku (deklarate per media)

Në 28 Qershor do të marrë fund kthimi i mësuesve e nxënësve në kope elektorale dhe do të nisë epoka e re e rilindjes së Arsimit të çliruar nga zinxhirët e interesave politike.

12 Prill 2009/Rama (Takim ne Has)

Këtë projekt ne do ta realizojmë duke e përfunduar rrugën dhe duke e lidhur kombin shqiptar me këtë rrugë. Madje, edhe Sali Berishën që ditën e inaugurimit të rrugës do të jetë në pension do e ftojme dhe do i japim mundësinë të presi një pjesë të shiritit të rrugës.

14 Prill 2009/Rama (Takim ne Lac)

Ajo që do të përbëjë shtyllën themelore të këtij programi, do të jetë zëvendësimi i ndihmës ekonomike si lëmoshë, me ndihmën ekonomike si mundësi reale si punësim dhe kontribut të drejtpërdrejtë në komunitet e në shoqëri.

Unë jam besimplotë, se në fund të mandatit tonë të parë, varfëria ashtu siç e matim sot, do të përgjysmohet. Vlerësimi ynë është se varfëria reale, është rreth 40 % dhe në zonat malore kalon mbi 50 %. Aktualisht 1 në 5 shqiptar jeton me më pak se 2 \$ në ditë, ndërsa 1 në 10 jeton me më pak se 1 \$ në ditë.

Vetëm për të paguar ujën, energjinë dhe bukën, në një muaj, është më shumë se sa ndihma ekonomike që i jepet një familje të varfër. Dhe përgjigja e duhur ndaj varfërisë, nuk është lëmosha, por punësimi.

15 Prill 2009/Sh.Idrizi (deklarate per shtyp)

I kërkojmë Qeverisë, që në këtë periudhë krize, të heqë për biznesin e vogël, por jo vetëm për të, të gjithë barrën fiskale antiligjore të vendosur nëpërmjet sistemit të referencave, të heqë praktikant antiligjore, që u cakton bizneseve pagat, çmimet e shitjes dhe blerjes, numrin e të punësuarve, rentabilitetin etj.

I kërkojmë Qeverisë, t'i kthehet parimit themelor të administrimit fiskal VETËDEKLARIMIT, duke i kthyer tatimet nga gjoba në kontribut për shoqërinë.

Megjithëse, Ne jemi të bindur se kjo kërkesë e përsëritur e jona, do të bjerë në vesh të shurdhër. Ne jemi më të bindur që shqiptarët me votën e tyre të 28 qershorit do t'i japin fund praktikave fiskale antiligjore e korruptive, që rëndojnë bizneset dhe xhepat e shqiptarëve.

15 Prill 2009/Rama (Takim Lezhe, program qeverisës)

Do krijojmë Fondin e Integritimit Social. Ky fond brenda 2010 do bëjë që familjet e varfëra të përfitojnë 50% më shumë. Në 2011 përfitimi do të jetë dyfish. Në fund të mandatit të parë përfitimi i ndihmës ekonomike 4 herë më i madh. Të gjitha këto, duke punuar në drejtin të nxjerrjes nga skema e ndihmës familjet, duke stimuluar punësimin e tyre.

15 Prill 2009/Rama me ish-ushtaraket

Unë jam këtu për t'ju thënë se ne nuk e diskutojmë vendimin e Gjykatës Kushtetuese lidhur me grupin tuaj të interesit. Të drejtat që burojnë nga ligji dhe janë konfirmuar dhe nga vendimi i GJ.K ne i njohim si detyrimet e qeverisë sonë që do të dalë me votën e 28 Qershorit.

18 Prill 2009/Rama (Takim ne Cerrik)

do ta reformojmë rrënjësisht shërbimin shëndetësor, dhe nga një shërbim shëndetësor i mbështetur te sigurimet, do ta kthejmë në një shërbim shëndetësor universal, për të gjithë popullsinë. Në këtë mënyrë asnjë njeri në çfarëdo moshe, për shkak të varfërisë nuk do të mbetet pa shërbimin shëndetësor.”

19 Prill 2009/Rama (Takim me persona me aftësi të kufizuara)

do të rishikohet sistemin e vlerësimit të paaftësisë, duke kaluar nga një vlerësim thjesht mjekësor, në vlerësim mjekësor dhe social. Individët që u shërbejnë personave me aftësi të kufizuara tha Rama, vitet që kalojnë pranë tyre do tu llogariten si vite pune për efekt pensioni.

Ne do ta rritim shumë e rimbursimit të karburantit për ju e për ata që si ju kanë nevojë për mbështetjen e shoqërisë, duke siguruar që pavarësisht ndryshimit të çmimit të karburantit, çdo person me aftësi të kufizuara, të mund të blejë të njëjtën sasi karburanti që i nevojitet. Periudha në shërbim të personave me aftësi të kufizuara, do të njihet si vjetërsi pune për efekt të pensionit të pleqërisë.”

Për të gjithë shqiptarët tha Rama do krijojmë Kartën Sociale, e cila do të sjellë një revolucionin që Shqipëria dhe shqiptarët kanë nevojë: “Duam që të krijojmë për çdo shqiptar e shqiptare, Kartën Sociale, e cila është një kartë që në bazë të profilit individuale dhe gjendjes shoqërore e ekonomike, t'i japë mundësi çdo qytetari e qytetareje të përfitoj në mënyrë të thjeshtë dhe tërësisht transparente shërbime e kujdes social e shëndetësor, arsimor, apo kulturor. Kjo sigurisht nënkupton një revolucion në marrëdhëniet mes qytetarit dhe shtetit dhe për këtë revolucion në radhë të parë që Shqipëria ka nevojë.”

20 Prill 2009/V.Leskaj (takim ne Shirgjan, Elbasan)

Ne do të lidhim marrëveshje me Greqinë dhe Italinë për njohje reciproke të periudhës së sigurimit për efekt pensioni, do të thotë ato vite pune që ke punuar në Shqipëri të bashkohen me vitet e punës në emigracion, në Itali apo Greqi, dhe nëse jeton në këto vende e merr pensionin aty, nëse jeton në Shqipëri e merr pensionin në Shqipëri.

21 Prill 2009/Rama (Takim ne Koplík, Malesi e Madhe)

Punësimi do të jetë për ne kryefjala e përpjekjes tonë dhe çdo njeri i papunë do të jetë njëri nga ne që ka nevojë për ndihmë.

Arsim kundër papunësisë. Nxitje e sipërmarrjes prodhuese kundër papunësisë. Fshat i mbështetur fuqishëm nga qeveria kundër papunësisë. Turizëm i zhvilluar kundër papunësisë. Ndihmë ekonomike kundër papunësisë.

22 Prill 2009/Rama (Takim ne Shkoder)

Pas 68 ditësh, ne do ta dëbojmë këtë fantazëm ndiellakeqe të centralit bërthamor nga dyert e këtij qyteti, që nuk mund të bëhet kurrë Gërdeci i Evropës dhe do ta mbyllim një herë e mirë në arkivin e gafave 18-vjeçare të politikës së vjetër idenë marroqe të centralit bërthamor në Shkodër.

23 Prill 2009/Rama (Kemishaj te Lushnjes dhe Grecalli te Fierit)

Të gjithë legjislacionin ekzistues mbi pronën në fshat dhe në tërësi ne do ta kthejmë në një kod të tokës. Do të ndërtojmë dhe aprovojmë në Parlament “Kodin e Tokës”. Do të përfundojmë regjistrimin në të gjitha zonat kadastrale të vendit dhe do ta nxitim zhvillimin e tregut të tokës, duke ofruar qoftë lehtësi fiskale, qoftë lehtësi proceduriale, sepse nuk mund të ketë treg shqiptar të zhvilluar pa tregun e tokës dhe nuk mund të shkojmë larg pa futur kapitalizmin në fshat.”

Ndaj në prezantimin e këtij kapitulli për fshatin, Rama është ndalur tek sistemi i administrimit të tokës dhe ristrukturimit të informacionit kadastral: “Nga ana tjetër, do të ndërtojmë një sistem të administrimit të tokës, duke unifikuar gjithë informacionin dhe duke ristrukturuar qoftë kadastrën ligjore, që është Zyra e Regjistrimit të Pasurive, por nga ana tjetër duke krijuar Kadastrën Shumëqëllimshme dhe njëkohësisht edhe Kadastrën Fiskale, për t’i dhënë mundësi të gjithë atyre që disponojnë truall bujqësor, apo truall në funksion të zhvillimit të fshatit, që për shkak të lehtësirës fiskale të mund ta përdorin këtë truall për interes të bujqësisë dhe zhvillimit të ekonomisë rurale.”

Një nga pikat themelore të këtij Programi është ngritja e një ministrie të veçantë për fshatin, që të përmbledhë të gjitha strukturat e domosdoshme dhe jo si deri më sot, ku kompetencat delegohen nga një ministri, në tjetrën: “Gjëja e parë që ne do të bëjmë, është se do të ndërtojmë një strukturë tërësisht të re, një ministri të veçantë tërësisht për fshatin, që do të quhet Ministria e Zhvillimit Rural dhe do të adresoj problemin e madh të rimëkëmbjes së fshatit, duke e parë si një potencial jo vetëm të jashtëzakonshëm, por edhe tërësisht të pashfrytëzuar, me vetdijen se nuk mund të ketë një Shqipëri evropiane që ushqehet normalisht, në rast se nuk ka një fshat shqiptar që prodhon në kushtet normale.”

“Bizneset agrare të reja ne do t’i pëjashtojmë nga çdo tatim fitimi dhe çdo taksë në 3 vitet e para. Nuk do ta qeverisim fshatin nga kutia e televizorit, nuk do ta qeverisim fshatin nga salla e Parlamentit, nuk do ta qeverisim fshatin me fjalime me gënjeshtër. Do ta qeverisim fshatin bashkë këtu, duke bërë të mundura gjëra që sot duken padrejtësisht të mundura.”

24 Prill 2009/Ilir Gjoni (deklarate per shtyp)

Strukturat e PS po monitorojnë me skrupulozitet çdo veprim individual a kolektiv të punonjësve të administratës që funksionin publik e shpërdoron për qëllime partiake. Partia Socialiste garanton se me ardhjen në pushtet pas 28 Qershorit do ta zhveshë administratën publike nga “sistemi i favoreve politike e korruptive”, i ngritur nga qeveria e Partisë Demokratike.

24 Prill 2009/B.Klosi (takim ne Sukth)

Sekretari Organizativ i Partisë Socialiste Blendi Klosi, u shpreh gjatë takimit me banorë të Sukthit, se brenda mandatit të ardhshëm qeverisës, Partia Socialiste do të 4-fishojë ndihmën ekonomike për shtresat në nevojë. “Brenda mandatit tonë”, tha ai, “ne do të bëjmë që mos ketë më familje të varfra që nga ndihmat e shtetit mos përballojnë dot jetën e tyre. E mos ketë prindër të cilët mos jenë dinjitozë karshi fëmijëve të tyre vetëm e vetëm se janë të varfër”.

24 Prill 2009/Rama (Takim ne Fushe Arrez)

Rama foli për masakrën që po u ndodh sot pyjeve shqiptare. Në këtë kontekst ai tha se, “ne do të marrim të gjitha masat e do bëjmë gjithcka me mish e me shpirt që ta ndalim këtë shkatërrim e që pasuritë tona të përbashkëta t’i vemë në dispozicion të shoqërisë sonë, duke ndryshuar rrënjësisht dhe marrëdhëniet me zonat rurale”.

24 Prill 2009/Rama (Takim ne Selenice te Kolonjes)

Do ta trajtojmë fshatin hnë mënyrë të posacme, duke ngritur një ministri e cila do të jetë, ministria r fshatit dhe do të quhet” Ministria e Zhvillimit Rural” që do trajtojë çështjen e mirëqenies së fshatit, si një hallkë e pazëvendësueshme në zinxhirin e krijimit të mirëqenies së shoqërisë sonë. dërkohë që unë sot, them me plot gojën, bazuar mbi dëgjimin shumë të vëmendshëm të njerëzve që jetojnë në fshat dhe në një analizë të ekspertëve tanë, se nafta për prodhimin në fshat do të jetë pa akcizë.Kjo sigurisht, do ta ulë në mënyrë të menjehershme dhe të ndjeshme koston e prodhimit.” Edi Rama duke folur dhe shpjeguar në detaje pjesë nga programi i ri qeverisës i socialistëve u shpreh cdo biznes i ri agrar do të jetë i përjashtuar nga tatim fitimi për 3 vjetët e parë, kjo për të bërë të mundur lindjen e sa më shumë bizneseve të reja në fshat gjatë qeverisjes së socialistëve pas 28 qershorit.

25 Prill 2009/Rama (Takim ne Libonik te Korces)

“Do të ngremë një Agjenci të Biznesit Agrar, e cila do të ketë si funksione kryesore, monitorimin dhe garantimin e cilësisë së farave, fidanëve, pesticideve, të fertilizuesve, informacionin mbi tregun dhe çmimet, shërbimet bujqësore dhe veterinarë për fshatin, garancinë e origjinës së produkteve dhe punën për profilizimin e biznesit agrar dhe rajoneve bujqësore.”

“Ne do ta shikojmë familjen në fshat, si një familje fermere, e cila duhet të orientohet dhe kthehet në një biznes agrar dhe gjëja më e parë që do të bëjmë, është që çdo biznes agrar, do ta përjashtojmë nga çdo taksë dhe nga çdo tatim fitimi në 3 vitet e para.”

“Themeli i kësaj rruge të re është dialogimi. Ashtu siç kemi 18 muaj që lëvizim nëpër Shqipëri, që vijmë tek ju për t’ju dëgjuar sot në opozitë, ashtu do të lëvizim dhe do të vijmë tek ju, për t’ju folur dhe dëgjuar e për të vendosur së bashku edhe nesër kur të jemi në qeveri.”

25 Prill 2009/L.Nikolla (Takim me banoret e Prosekut)

Do të kemi një shërbim shëndetësor universal tha Lindita Nikolla në Prosek të Mirditës. Kjo nënkupton, që edhe pse gati gjysma e popullsisë nuk është e mbuluar me sigurime shëndetësore përsëri cdo individ do përfitojë nga shërbimi shëndetësor, nuk ka rëndësi nëse është i siguruar apo jo. Ky është një revolucion në konceptin e qeverisjes theksoi Nikolla, pasi është e domosdoshme që askush të mos mbetet pa shërbim shëndetësor pse është i varfër apo pse është i papunë: “Detyra jonë është që të ndryshojmë Shqipërinë dhe për këtë duhet të punojmë jo me fjalë të mëdha, jo me retorika elektorale, jo duke bërtitur dhe duke premtuar atë që nuk bëjmë, por duke premtuar gjithçka që ne kemi diskutuar së bashku dhe duke vendosur prioritetet dhe listat e nevojave që ne kemi identifikuar së bashku për t’i zbatuar.”

25 Prill 2009/V.Leskaj (Takim me biznesin fason ne Elbasan)

Janë të parashikuara në program elementë të mbështetjes së biznesit, që kanë të bëjnë me sistemin e taksave apo investimeve në fushën e arsimit dhe formimit profesional. Për ne arsimimi profesional është shumë i rëndësishëm, pasi i ofron biznesit punëtorë të kualifikuar dhe mundësi që ai të eci. Arsimi së bashku me mbështetjen e biznesit janë nga fushat prioritare që kemi parashikuar në programin tonë, sepse ky vend duhet të zhvillohet, njerëzit kanë nevojë të punësohen dhe kanë nevojë për një jetë më të mirë.”

26 Prill 2009/Rama (Takim ne Ormen e Pirg)

“Do të shpallim edhe minimumin jetik, që do të thotë se ne nuk do të lejojmë që të ketë familje shqiptare nën minimumin jetik, duke filluar nga pagesa e papunësisë, që së paku do ta dyfishojmë. Por i gjithë koncepti ynë dhe thelbi i filozofisë tonë të re, është se varfëria dhe papunësia luftohen duke nxitur punën, duke nxitur prodhimin, duke nxitur integrimin e familjeve që janë në ndihmë ekonomike, drejt punës dhe drejt aktivitetit prodhues.”

27 Prill 2009/V.Leskaj (Deklarate per shtyp)

Në emër të PS dua të garantoj se pas fitores së 28 Qershorit, Qeveria e Re e cila ka në themel të programit të saj integrimin e vendit, do marrë të gjitha masat dhe do ketë angazhimin maksimal për ta bërë vendin tonë anëtar të BE duke plotësuar ëndrrën 18 vjecare për ta bërë Shqipërinë si gjithë Europa.

28 Prill 2009/T.Balla (Deklarate per shtyp)

PS garanton se në Programin e saj qeverisës, ka parashikuar hapa konkretë që përmbushin detyrimet për liberalizimin e vizave brenda 6 mujorit të parë të qeverisjes, duke mundësuar kështu shqiptarëve lëvizjen e lirë në hapësirën shengen.

29 Prill 2009/Y.Manjani (Deklarate per shtyp)

PSSH shpreh edhe njëherë besimin se zgjidhja përfundimtare e çështjes së pronës do të takojë qeverisjes së saj të pas zgjedhjeve. Në vizionin tonë zgjidhja e kësaj çështje ka rëndësi kombëtare dhe strategjike. PSSH e sheh zgjidhjen e kësaj çështje nëpërmjet harmonizimit të interesave të pronarëve me ato të të gjithë shqiptarëve. Në këtë funksion dialogu social dhe qeverisja konsensuale e shqiptarëve të pas 28 Qershorit do ta zgjidhë këtë çështje përfundimisht.

29 Prill 2009/B.Klosi (Takim ne ish-kenete Durrës)

Zona e Kënetës do të duhet të jetë një nga ato zona, që PS do duhet të gjej mbështetjen e saj të madhe, sepse kjo zonë është një zonë që sot më shumë se çdo zonë tjetër në Qarkun e Durrësit vuan varfërinë. Është kjo zonë, që më shumë se çdo zonë tjetër do ndryshim. Kjo s' duhet të jetë zonë informale për ne. PS pa dyshim në programin e saj, problemin e zonave informaleve dhe legalizimeve e ka mëse të qartë. Ne ashtu si më përpara, në asnjë rast nuk do të jemi kundër legalizimit. Ato shtëpi që i keni ndërtuar me djersë, do të duhet t'i gëzoni. Programi i PS flet qartë, se ato shtëpi duhet t'i gëzoni. PS në programin e saj elektoral, e shpreh qartë se përpara duhet të ishte bërë urbanizimi. Ju nuk duhet të jetoni mirë vetëm brenda shtëpisë, por edhe jashtë saj. Këto zona kanë më shumë nevojë për investime në infrastrukturë, ujë, kanalizime, ka nevojë që fëmijët tuaj të jetojnë mirë brenda shtëpisë dhe jashtë saj të gjejnë zonë urbane dhe të mos jetë ish-Kënet, por të jetë Durrësi i ri, Durrësi i ndryshimit."

29 Prill 2009/Rama (Deklarate per media)

Pjesëmarrja më e lartë, e grave në Parlament pas 28 qershorit do të tregojë me prova se sa i mangët ka qenë Parlamenti deri më sot dhe se sa më shumë akoma do të duhet ta shtojmë pjesëmarrjen e grave për të pasur Parlamentin që na duhet për të bërë ligjet e duhura, e për të mundësuar gjithë ato që deri më sot nuk janë bërë - jo se sbëhen dot, por sepse ka munguar vullneti për t'i bërë.

30 Prill 2009/Beqja (Deklarate per media)

Pas 28 Qershorit, Partia Socialiste, jo vetëm që do të tregojë transparencë mbi situatën ekonomike në vend, por i siguron fasonistët dhe gjithë sipërmarrjen shqiptarë se: do të jetë në krah të tyre, do të c'instalojë sistemin e pagave dhe cmimeve të referencës, do të rimburojë tatimin mbi vlerën shtuar.

1 Maj 2009/Rama (Takim ne Bulqize, program per minatorët)

Pasi ta nxjerrim në pension Sali Berishën në 28 qershor, do të përcaktojmë kufirin e veçantë për pension për moshën e minatorëve. Që do të thotë, se politikanët po të duan, le ta bëjnë moshën e pensionit të tyre 80-vjec, ndërkohë që për minatorët ne do ta frenojmë moshën e pensionit qysh në janarin e vitit 2010.

Unë sot këtu dua t'ju them, se për mua statusi i minatorit është detyrimi karshi të gjithë atyre, socialistëve dhe demokratëve, që kanë jetuar dhe kanë sakrifikuar nën tokë, i të gjithë fëmijëve të tyre, fëmijëve të socialistëve dhe demokratëve, që njësoj meritojnë të rriten normalisht, me nënën dhe babain dhe njësoj meritojnë që të kenë nesër një Shqipëri evropiane. Ne do ta firmosim statusin minatorit.

2 Maj 2009/Ruci (Takim ne Cerem)

Do të marrin fund një herë e mirë me rregullimet ligjore, me përmirësimet ligjore, që secili nga ju të ketë dokumentin dhe të gëzojë vërtetë pronësinë mbi tokën që ka në dispozicion. Nuk mjafton vetëm kjo, por me infrastrukturën ligjore që e ka të gatshme PS, që në vitin e parë, do të rregullojë të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore, lidhur me qeramarrjen e tokës, me shitblerjen e tokës dhe me ruajtjen e tokës. Të njëjtën gjë do të thojë lidhur me shërbesat që i duhen bërë tokës dhe këtu e kam fjalën për sistemin e vaditjes, e cila nuk mund të bëhet më me shoqata, por mund të bëhet vetëm nëpërmjet një ministrie, që nuk do të quhet thjesht Ministri e Bujqësisë, por Ministri e Zhvillimit Rural.”

2 Maj 2009/Rama (Takim në Durres)

Rama shtoi se nuk kemi një sistem të pranueshëm të njësive hoteliere të turizmit. Ne do ta ngremë këtë sistem licensimi dhe vlerësimi, në bazë të standarteve evropiane. Qëllimi ynë tha Rama është të integrojmë shërbimet tona turistike në rrjetin Europian të shërbimeve turistike. Duke qenë të hapur, dhe aspak paragjykes ndaj zhvillimeve të reja, duke qenë të hapur dhe aspak paragjykes ndaj të gjitha kërkesave për investime në sektorin energjistik, ne do të bëjmë një politikë të re, të qartë dhe të vendosur, për të zbrapsur prurjen në Shqipëri dhe ngritjen në Shqipëri të të gjitha rrangallave dhe hekurishteve që nuk janë më të pranueshme për Evropën ku ne duam të integrohemi.

5 Maj 2009/Blushi, Dalipi, Ahmetaj (Takim në Udenisht)

Më 28 qershor, ne do të shkojmë të votojmë për të shpëtuar nga varfëria dhe mjerimi. Ne kemi një projekt, të cilin e theksoj, fillon nga fshati, duke i dhënë dinjitet, duke i dhënë gjithsecujt atë që meriton, duke i dhënë fshatarit dhe fermerin tokën e vet. Sigurisht, që fshati do të jetë prioriteti i madh i Partisë Socialiste, sepse në fshat, përveç certifikatës së tokës, ne do të subvencionojmë prodhimet bujqësore, që sot nuk arrijnë të shkojnë dot në tregun e qytet. Në fshat ne do të reduktojmë koston e lartë të prodhimeve, duke zhdukur akcizën e naftës. Lista e borxheve në dyqane, në thertore, etj, është më e gjatë se Sali Berisha, është më e gjatë se 14 ministrat e kësaj qeverie.”

6 Maj 2009/Rama (Takim me ish punonjes të policisë të liruar)

“Ne duam dhe do të ndërtojmë një strukturë të integruar të sigurisë kombëtare, e cila do të jetë përgjegjëse për përmirësimin e faktorëve të rrezikut që i kanosen sigurisë dhe do të planifikojë politikën e integruara të ndërhyrjes sipas rastit. Kjo strukturë do të hartojë politikën për rendin dhe sigurinë publike, për shërbimin e emergjencave civile, për sigurimin dhe qarkullimin e informacionit të klasifikuar dhe për mbrojtjen e integritetit territorial”

7 Maj 2009/Rama (Takim me emigrantet)

përmes një kanali të dytë të televizionit publik, i cili një ndër programet kryesore dhe të përditshme, do të ketë programin për mësimin e gjuhës shqipe në çdo cep të globit ku jetojnë shqiptarë, që do të duan t'i rritin fëmijët me gjuhën shqipe.

Politika jonë e re e ndryshimit, do të synojë dhe do të realizojë transformimin e shërbimeve në ambasada dhe konsullata për shqiptarët e shqiptarët, në shërbimet e standardeve evropiane të njëjta me ato shërbime që motrat dhe vëllezërit tanë marrin në sportelet e atyre vendeve ku jetojnë, si qytetarë dinjitoz të atyre vendeve.

Këtë, ne do ta ndryshojmë dhe me politikën tonë të re të ndryshimit. Ne do të bëjmë të mundur që në një sërë sportesh kryesore, në Evropë, Amerikë, Kanada, emigrantët e emigrantet shqiptarë të mund të aplikojnë dhe të marrin pasaportën biometrike.

Ne do të bëjmë një politikë të re ndryshimi edhe në këtë aspekt dhe do të bëjmë marrëveshje dypalëshe për sigurimet shoqërore të të gjithë emigrantëve shqiptar, të cilët nuk do të humbin asnjë ditë pune lidhur me sigurimet shoqërore dhe pensionin.

të mos i shohim emigrantët dhe emigrantet thjeshtë si ndihmë për mbijetesën për familjet e tyre, por t'i shohim edhe si burim potencial investimesh, duke filluar në radhë të parë nga fshati.

Për këtë arsye, në programin tonë, ne kemi një paketë stimuluese për investimet në ekonominë rurale të të gjithë atyre burrave dhe grave, djemve dhe vajzave, që çojnë kursimet e tyre drejt fshatit ku jeton familja e tyre.

Duke e mbyllur, unë dua të garantoj, se qysh në ditët e para të qeverisë tonë, ne do të fillojmë punën për ta kthyer alternativën e Grupimit 99 për votën e emigrantëve, në një projekt të qartë dhe të përcaktuar, të cilin të gjithë aleatët e koalicionit tonë të bashkimit të ri për ndryshim, do ta njohin si projektin e tyre të përbashkët.

8 Maj 2009/Rama (Mengjes pune me gazetaret)

Kjo ishte ajo për të cilën unë pata dëshirë të jem me ju sot këtu, duke besuar që vota e emigrantëve është një mungesë e qënësishme në procesin tonë demokratik dhe krijimi i mundësive për të votuar jashtë Shqipërie është një objektiv i plotësueshëm i yni pas 28 qershorit.”

9 Maj 2009/Rama (Takim ne UZnove)

Ne abetaren dhe librat e shkollës do t'i japim falas për të gjithë fëmijët e varfër, jo me rimbursim, por drejtë e në dorë.”

11 Maj 2009/Rama (Takim ne Orikum)

Me votën e 28 qershorit, ne së bashku do të hapim një faqe të re në historinë tonë të përbashkët, duke filluar nga dhënia e certifikatave të pronësisë, të gjithë atyre shqiptarëve që disponojnë tokën në bazë të ligjit 7501.”

Premtimi i Ramës për këtë çështje është: cdo pronë që është e lirë do t'i kthehet pronarit, çdo tokë që është marrë me ligjin 7501, do t'i jepet menjëherë me letër dhe vulë pronarëve të saj, që janë ata që e kanë marrë me ligjin 7501. Kjo tha Rama pasi në dy vjet dialog me njerëzit në mbarë vendin çështjet e pronësisë kanë qenë fenomeni i hasur në cdo cep të Shqipërisë:

11 Maj 2009/Balla (Takim ne Librazhd)

Fëmijet jetim. Ajo që mund t'ju garantoj unë dhe Partia Socialiste, është se qeveria e re pas 28 qershorit, do të hyjnë konsultime të drejtpërdrejta me shoqatën tuaj dhe me ju, në mënyrë të tillë që ne të ndërtojmë një mekanizëm që me të vërtetë fëmijët jetimë pa nënë ose pa baba, të garojnë të barabartë në fushën e jetës me të gjithë fëmijët e tjerë.” Balla kujtoi se ende fle , që nga fillimi i vitit 2007, në sirtarët e Kuvendit një projektligji i depozituar nga këto nëna, por që mazhoranca e nuk e ka përfillur, kjo do të ndryshojë me qeverinë e dalë nga zgjedhjet e 28 qershorit tha Balla.

12 Maj 2009/Rama (Takim ne Vlore)

“Dy projektet e mëdha për të cilat unë do të angazhohem me mish e me shpirt për Vlorën do të jenë fillimi i ndërtimit të një porti europian dhe fillimi i punës për një universitet europian për Vlorën.”

15 Maj 2009/Rama (Takim me investitorët e huaj)

Një nga pikat që e kemi të theksuar në programin tonë, është pikërisht rimbursimi i TVSH, të cilës do t'i shtojmë dhe incentivat fiskale në lidhje me importin e makinerive të reja, si dhe investimet.

Ajo që duam të trajtojmë ne në mandatin tonë të parë, është krijimi i "Kodit të Tokës".

Një kadastër multifunkionale e cila mungon plotësisht në Shqipëri, por që është një motor i rëndësishëm për t'i dhënë një kuptim dhe drejtim investimeve të reja dhe ekonomisë në përgjithësi. "Kodi i Tokës" nga njëra anë dhe një kadastër multifunkionale nga ana tjetër së bashku, do të bëjnë të mundur një ndryshim të dukshëm në drejtimit të administrimit të tokës.

16 Maj 2009/L.Shamku (Konferenca kombetare e Programit te PS)

tek forcimi i identitetit europian e kombëtar në gjithë sistemin tonë arsimor, publik e privat e në të gjitha ciklet dhe natyrat e shkollimit!

- tek edukimi me vlera shpirtërore që kultivojnë ndjenjën e qytetarisë e të përkatësisë europiane!
- tek shkollimi i gjithsekujt sipas talentit dhe aftësisë, duke e shndërruar shkollën në një kultivuese të vërtetë dhuntish e mundësish!
- tek shkollimi me laboratorë moderne e mjete didaktike funksionale, ku mësues e pedagogë nuk detyrohen më të shpjegojnë me gishta!
- tek arsimit që garanton punësim, që bazohet në teknologji dhe vlera qytetare, e që siguron punë në Shqipëri dhe jashtë saj!
- tek shpërblimi real i punës së arsimtarëve, duke mos u ndalur vetëm të paga po edhe të rivendosja e dinjitetit të tyre!
- tek unifikimi i vërtetë i programeve tona shkollore me ato të Europës, për ta përmbushur kësaj ëndërrë që përkund çdo prind shqiptar për bijtë e vet!
- tek politika që në raportin sistem publik–sistem privat, e sheh privatën si partner të shtetit drejt synimit të përbashkët!
- tek shndërrimi i Shqipërisë në një kantier të vërtetë mundësish shkollimi e kursesh riaftësimi!
- tek qeverisja që arsimin e ka zë kryesor në buxhetin e saj dhe këtë nuk e konsideron thjesht si shpenzim, por si një investim për të ardhmen!
- tek ato politika arsimore që nuk lindin në zyrat e dikastereve, por formësohen e zbatohen në dialog të pandërprerë me shqiptarët!

16 Maj 2009/Rama (Konferenca kombetare e Programit të PS)

Do të ngremë një ministri të posaçme për fshatin që do të quhet Ministria e Zhvillimit Rural dhe do dyfishojmë menjëherë buxhetin e bujqësisë

Duke filluar nga kujdesi për foshnjat qysh në barkun e nënës, librat e shkollës falas për fëmijët, arsimimi profesional për të rejat e të rinjtë e fshatit, shërbimi shëndetësor për të gjithë dhe një plan tërësor për rindërtimin e marrëdhënieve mes fermerit e shtetit mbi bazën e interesave reciproke.

Asnjë bujk dhe fermer pa certifikatën e pronësisë mbi tokën. 18 vjet pas ligjit 7501, ne do të sigurojmë zbatimin përfundimtar të këtij ligji duke i dhënë fund ankthit, talljes e poshtëritimit 18 vjeçar të qindramijëra bujqve e fermerëve që janë dhe s'janë zotër të tokës së tyre.

Asnjë bujk, fermer e peshkatar pa shtetin pranë për të ulur kostot e prodhimit dhe garantuar infrastrukturën e tregut të shitjes së tij.

Asnjë familje shqiptare në fshat pa ndihmën e shtetit, duke filluar nga nënat e reja. Të cilat s'do kthehen më, pak ditë pas lindjes, në arë për të ndjekur parrmendën që të ushqejnë familjen dhe foshnjën, sepse nuk përfitojnë nga barrë lindja për shkak të varfërisë. Çdo nëne e re që sjell gëzimin e lindjes së një fëmije në një familje të varfër, do të përfitojë nga barrë lindja njësoj siç do grua tjetër në këtë vend, duke gëzuar mbështetjen tonë gjatë gjithë vitit të lejes së lindjes. Sepse Shqipëria e shekullit XXI s'mund të jetë nënë për gjysmën e të porsalindurve dhe njerë për gjysmën tjetër. Janë sot 50% nënat shqiptare që e kanë këtë problem që pas 28 qershorit ne do ta zgjidhim.

Alternativa jonë është radikale, shërbimi shëndetësor universal. Jo më sigurime shëndetësore, po financim publik i shëndetësisë sipas një modeli të suksesshëm dhe gjithnjë e më të përhapur evropian.

Së bashku, ne do ta shpallim armik e do ta luftojmë me forcë të paparë analfabetizmin, duke i dhënë fund 18 vjetëve kaos e anarki në programet mësimore të arsimit bazë dhe arsimit të mesëm të përgjithshëm. Ne do t'i njehsojmë ato me një model evropian të përafër, si edhe do të punojmë ngushtësisht me qeverinë e Kosovës, për të pasur e zhvilluar të njëjtin model programesh arsimore në gjithë trevën shqiptare.

Me qeverinë tonë, do të lindë edhe arsimiti i vërtetë profesional në Shqipëri ku janë harruar zanatet dhe ku zanatçinjtë e gënjeshtrave në politikë dhe qeverisje ofrojnë si zgjidhje të vetme për papunësinë e të rejave dhe të rinjve, shqyerjen e detyrës të universitetit dhe çeljen e tyre pa asnjë kriter e karar.

Ne do ta pastrojmë Shqipërinë nga plehurat e kudondodhura nëpër rrugët urbane dhe ato kombëtare e nga mbeturinat urbane të hedhura kuturu ngado hedh sytë, të cilat janë shembulli më i keq që u japim fëmijëve tanë, qytetarëve të së nesërme së Bashkimit Evropian.

Në katër vitet e ardhshme, do të mbjellim në Shqipëri më shumë pemë se ç'janë mbjellë në këto 18 vjet të marra së bashku dhe së bashku do t'u japim njerëzve jo shifrat e një ekonomie që rritet bashkë me papunësinë, por mundësinë e të jetuarit me punë në një ekonomi që zhvillohet përmes hapjes së vendeve të reja të punës.

Pas 28 qershorit policia e Shtetit Shqiptar, do t'i përgjigjet në mënyrën më shembullore sfidës së vendosjes së ligjit në të gjithë territorin, duke u angazhuar krah për krah me qytetarët e ndershëm të këtij vendi, për të mbrojtur jo vetëm jetën e tyre nga krimi e nga aksidentet e shmangshme, por edhe këtë pasuri të përbashkët që quhet Shqipëri dhe që prej 18 dhjetësh bëhet copa e çika prej një agresioni të pashembullt mbi rrugët, zonat e banuara, plazhet, pyjet, lumenjtë, tokën bujqësore, prodhimin e saj energjetik e burimet e saj natyrore.

16 Maj 2009/Beqja (Konferenca kombetare e Programit te PS)

Ne do të ofrojmë mbulim universal me shërbim shëndetësor për të gjithë shqiptarët, pavarësisht nga të ardhurat e tyre, gjendja shoqërore, vendbanimi, gjinia apo mosha.

Shërbimi shëndetësor që ne do të ngremë do të shtrihet në të gjithë vendin dhe do të mbështesë në të gjitha hallkat e ecurisë së kujdesit për shëndetin. Ne do t'u ofrojmë qytetarëve tanë, vëmendje gjatë gjithë zinxhirit të shërbimeve që ata kanë nevojë përfshirë parandalimin, trajtimin dhe rehabilitimin. Do të reduktojmë sorollatjet dhe radhët duke përmirësuar planifikimin dhe koordinimin.

Ne do të koordinojmë sistemin e vërtetë publik me atë privat. Ne do të ofrojmë shërbime të sigurta ku qytetarët do të kenë mundësinë të zgjedhin midis shërbimit shëndetësor publik apo atij privat. Ne do të vlerësojmë, akreditojmë dhe monitorojmë çdo ofrues të shërbimit shëndetësor publik dhe privat.

Ne do të mundësojmë që të gjitha barnat në Shqipëri të shiten kudo njësoj dhe jo më shtrenjtë sesa në tregun e vendit të origjinës. Ne do të rrisim cilësinë dhe sigurinë e barnave duke shtuar kujdesin për indikacionet e barnave në përputhje me standardet europiane. Ne do të rrisim kontrollin e cilësisë gjatë të gjithë zinxhirit të shpërndarjes së barnave.

Ne do të financojmë më shumë për shëndetin publik dhe programet e parandalimit. Ne do të ndërtojmë përgjigjen e koordinuar kombëtare për ruajtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë.

Ne do t'u ofrojmë mjekëve dhe infermierëve tanë njohuritë, shpërblimin dhe teknologjitë e nevojshme për të shëruar dhe shpëtuar jetë njerëzish.

16 Maj 2009/Malaj (Konferenca kombetare e Programit te PS)

Ne do të synojmë një inflacion të ulët.

Ne do të reduktojmë deficitin buxhetor.

Ne do të reduktojmë borxhin publik dhe koston e tij.

Brenda 50 ditëve të para të mandatit do të prezantojmë një paketë antikrizë.

Ritme më të larta rritjeje ekonomike, për vitet 2011-2013 do të jetë mbi 6%

Ulje e papunësisë në 9%,

Inflacion - jo më shumë se 3% në vit.

Deficit buxhetor jo më shumë se 3%

Borxhi publik në vitin 2013 jo më shumë se 50% e PBB.

Borxh publik vetëm për investime

Politika fiskale lehtësuese e nxitëse për teknologjitë moderne.

Transparencë maksimale për çdo politikë fiskale dhe buxhetore.
Bashkëpunim maksimal dhe efikas me Institucionet Financiare Ndërkombëtare.

16 Maj 2009/Ervin Bushati (Konferenca kombetare e Programit te PS)

Rritja e mirëqenies në fshat dhe garantimi i pronës dhe i sigurisë social-ekonomike.
Bashkë do të mbështesim prodhimin vendas nëpërmjet zhvillimit, profilizimit dhe konsolidimit të Biznesit Agrar në një treg funksional. Biznesi Agrar do të përjashtohet nga taksat për 3 vite.
Synojmë rritjen e ekonomisë rurale me aktivitete si: agroindustria, turizmi, bimët e egra dhe medicinale, produktet bio dhe artizanale, peshkimi, pyjet, gjuetia dhe agroturizmi.

16 Maj 2009/Rudina Seseri (Konferenca kombetare e Programit te PS)

Alternativa jonë për ZHVILLIMIN E SHQIPËRISË, do ta ulë papunësinë në nivelin njëshifror, 9%; do të përgjysmojë nivelin e papunësisë në fshat dhe deri në fund të mandatit tonë, do të bëjë të prekshme 197,000 mundësi të reja punësimi.

Do të mbështesim veçanërisht punësimin e të rinjve dhe grave. Deri në vitin 2013 do të eliminohet puna e fëmijëve nën 16-vjeç në sektorin formal, do të ulët informalitetin dhe parandalohet shfrytëzimi i fëmijëve në ekonominë gri, duke i hequr kësaj shoqërie turpin e këtyre fenomeneve njëkohësisht të shëmtuara dhe të dhimbshme.

Ne do të eliminojmë çdo vonesë në rimbursimin e TVSH dhe çdo taksë dhe tatim të paguar më tepër.
Fillimisht në ditët e para të mandatit tonë, ne do të shfuqizojmë dhe hedhim poshtë ligjet anti – biznes: Rishikimi dhe përmirësimi sa më parë i çdo ligji ekonomik dhe fiskal që ka rritur vështirësitë për biznesin dhe ka inkurajuar abuzivitetin e administratës fiskale. Nën qeverisjen tonë, asnjë ligj dhe akt ligjor, nuk do të miratohet nga Parlamenti dhe qeveria pa u diskutuar me transparencë me komunitetin e biznesit dhe grupet e interesit.
Teknologjia dhe dija janë dy shinat mbi të cilat ecën treni i zhvillimit. Ne do të heqim çdo ngarkesë fiskale për importet e teknologjive moderne dhe për ekonominë e dijes.

Ne i kuptojmë vështirësitë e biznesit në këto kohë krize, ndaj jemi në anën e tyre për të kapërcyer bashkë me ta vështirësitë e momentit. Ne do të mbështesim marrëveshjet për ristrukturim të kredive të këqija midis bankave dhe biznesit dhe do të propozojmë krijimin e një fondi garancie për likuiditet.

16 Maj 2009/Besnik Baraj (Konferenca kombetare e Programit te PS)

* Integrim të komponentes mjedisore në politikat ekonomike të zhvillimit të vendit, duke ndikuar pozitivisht në drejtimin, koston dhe ritmet e ecurisë ekonomike, shëndetit të popullit dhe sigurisë kombëtare.

* Adopim të politikave që mundësojnë shfrytëzimin racional e të qëndrueshëm të natyrës, duke shërbyer si gjenerator mundësish për të hapur fronte pune dhe për të zhvilluar biznese që janë në harmoni me mjedisin.

* Ndërhyrje energjike me faktorë financiarë, menaxhues dhe instrumente ligjorë për të penguar degradimin e natyrës dhe zmadhimin e borxhit të madh mjedisor që po u krijojmë brezave të ardhshëm.

* Mbrojtje të mjedisit me një përqsje të re, duke e konsideruar dhe menaxhuar atë në mënyrë integrale, në bashkëpunim me qytetaret, ekspertët, organizatat mjedisore, sistemin tonë arsimor, median dhe biznesin privat.

* Partneritet serioz në bashkëpunimet bilaterale dhe multilaterale, si dhe me konventat ndërkombëtare për të përmbushur, jo thjesht në letër detyrimet që rrjedhin prej tyre, por edhe të rikthejmë seriozitetin e cenuar në projektet me institucionet ndërkombëtare.

* Arritje të standardeve mjedisore, për rehabilitimin e zonave të ndotura, të pyjeve, për uljen e ndotjeve në ajrin urban, në ujërat sipërfaqësore dhe për zvogëlimin e erozionit, si parakushte për të realizuar me sukses integrimin në Bashkimin Europian.

16 Maj 2009/D.Bushati (Konferenca kombetare e Programit te PS)

Ne do të bëjmë realitet ëndrrën europiane të shqiptarëve për të lëvizur pa viza në hapësirën Shengen brenda vitit 2010, duke përmbushur me rigorozitet 42 standardet e trupëzuara në Udhërrëfyesin e Liberalizimit të

Vizave që kanë të bëjnë me: Sigurinë e dokumenteve; Migracionin ilegal, Menaxhimin e Integruar të Kufijve dhe Politikat e Ripranimit; Rëndin Publik dhe Sigurinë përmes luftës ndaj krimit të organizuar, korrupsionit, bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale dhe shtrëngimit të ligjit.

Paralelisht me marrjen e statusit të vendit kandidat për në BE dhe përgatitjen për fillimin e negociatave për anëtarësim, ne do të përsheptomë reformat që synojnë menaxhimin në mënyrë të decentralizuar të fondeve të para aderimit që kanë të bëjnë me zhvillimin rajonal, rural dhe zhvillimin e burimeve njerëzore.

23 maj 2009/V.Leskaj (takim ne kongresin e egjiptianeve)

Ne e kemi parashikuar që jo më vonë se 60 ditë nga krijimi i qeverisë së re, do të ngremë një Komision të përbërë me përfaqësuesit tuaj dhe nga specialistë nga më të mirët e vendit, të cilët do të punojnë për identifikimin e nevojave dhe të problemeve që ka ky komunitet (Egjiptian). Ne marrim përsipër që të hartojmë një strategji kombëtare për ju, sepse është e palejueshme që deri sot janë hartuar strategji kombëtare për të gjitha grupimet, për të gjitha minoritetet, për shumë kategori, për shumë fusha, por nuk ka ende një strategji kombëtare për ju.

24 Maj 2009/Rama (Takim ne Bilisht te Korces)

Ne nuk ju premtojmë, por angazhohemi solemnisht përpara jush, se pas 28 qershorit, naftën do ta keni pa akcizë.”

Kjo do të ndryshojë,”- tha Rama, “do ngremë shërbim shëndetësor universal që do t’i shërbejë të gjithëve pavarësisht kontributeve të paguara ose jo të sigurimeve shëndetësore:

25 Maj 2009/Rama (Takim me emigrantet ne Greqi)

Marrëveshje dypalëshe mes Greqisë, Italisë e Shqipërisë për njohjen e periudhës së sigurimeve, për efekt pensioni- ky ka qenë një tjetër premtim që Edi Rama u ka bërë shqiptarëve që punojnë jashtë atdheut nga Greqia.

Ne nuk ju premtojmë, por angazhohemi që duke i dhënë fund ecejakeve tuaja dhe radhëve të pafundme në kufij për të marrë një copë letër këtu dhe një copë letër atje. Duke i dhënë më në fund mundësinë çdo kujt prej jush që të hyjë dhe të dalë nga Shqipëria sa herë të dojë. Ne, gjithashtu, do t’i japim mundësinë çdo kujt prej jush që një sërë shërbimesh të cilat sot ju nuk mund t’i merrni dot prej ambasadës, me ardhjen tonë në qeveri t’i merrni në ambasadë.

Qysh në vjeshtën e këtij viti ne do të fillojmë që të bëjmë të mundur aplikimin për kartë identiteti apo për pasaportën biometrike në ambasadën tonë në Athinë dhe pa asnjë dyshim në konsullatën tonë në Selanik e në vende të tjera.

Ne do të bëjmë gjithçka me qeverinë greke për të rritur numrin e shkollave shqipe. Pas fitores së 28 qershorit do të hapim një kanal të dytë në televizionin publik shqiptar ku një nga emisionet më të rëndësishme do të jetë ai që do t’i kushtohet mësimin të gjuhës shqipe për të gjithë fëmijët shqiptarë në Greqi, Itali, Amerikë e kudo.

Ju sakrifikoni, punoni si pakkush për të garantuar të ardhura për familjet këtu dhe për familjet tuaja në Shqipëri. Ne pas 28 qershorit do të fillojmë negociatat qoftë me qeverinë greke, qoftë me qeverinë italiane për njohjen e të gjithave viteve të pensionit dhe për të gjithë skemën e sigurimeve tuaja shoqërore përmes një marrëveshje dypalëshe.

Unë ju jap fjalën, ju jap fjalën se është hera e fundit që për të shprehur vullnetin tuaj juve duhet të bëni rrugë për të shkuar në qytetin apo fshatin tuaj në Shqipëri, herën tjetër ne do të garantojmë votën tuaj nga këtu ku jeni.”

29 Maj 2009/Rama (Takim ne Lushnje)

Ja pse jemi ne këtu, që pas 29 ditësh t’i japim fshatit një ministri të posaçme, t’i japim bujqësisë dyfishin e buxhetit, t’i japim çdo bujku e fermeri certifikatën mbi tokën në bazë të ligjit 7501, t’i japim shtetit në krah të

gjithë atyre që prodhojnë ushqim dhe t'i japim fund familjeve të kequshqyera dhe fëmijëve të paushqyer në Shqipëri.”

30 Maj 2009/Blushi (Takim ne Menkulas)

kemi vendosur ta shpëtojmë fshatin nga varfëria. Ne kemi vendosur të fillojmë duke ulur koston e prodhimeve bujqësore, kemi vendosur çmimin e naftës në mënyrë që ulja të ndikojë direkt në uljen e kostove të prodhimeve tuaja. Kemi vendosur që të kemi një ministri të veçantë për fshatin. Një ministri e cila do ndërhyjë fshat më fshat të Shqipërisë, do të ndërhyjë aty ku ka nevojë për një rrugë, aty ku ka nevojë për një shkollë, aty ku ka nevojë për kanalizime, aty ku ka nevojë për tregje, aty ku ka nevojë për të ulur koston e prodhimit bujqësor.”

3 Qershor 2009/Rama (Takim ne Berat dhe Kucove)

Qeverisja jonë do jetë e të gjithëve, tha Rama, duke ripërsëritur premtimin e tij se çdo vendim pas 28 qershorit do të merret në konsultë me grupet e interesit, por dhe me njerëzit ashtu siç ndodhi me programin e PS gjatë viteve në opozitë.”

3 Qershor 2009/Leskaj (Takim ne Shtermen, Elbasan)

Ne do të mbështesim biznesin agrar. Do të mbështesim biznesin agrar duke përjashtuar nga taksat dhe tatimet deri në tre vjet të gjitha bizneset e reja. Të gjitha bizneset e reja, sepse biznesi në fshat ka nevojë për lehtësi që të zhvillohet dhe përveç kësaj marrim përsipër mbështetjen për farat, plehrat, kimikatet, për heqjen e akcizës së karburantit, që siç e dini zotëria që është sot në pushtet tha që do tua jap edhe më të lirë se sa pa akcizë por në fakt ua dha shumë më të shtrenjtë se sa ai që gjeti pa akcize.

3 Qershor 2009/Rama (Takim ne Kombinat)

Edhe 25 ditë për të ngritur Komitetin Shtetëror të Zhvillimit të Rrethinave, nën varësinë e drejtpërdrejtë të Kryeministrit të vendit, për t'iu dhënë të gjithë të ardhurave që jetojnë në mjerimin e zonave informale, politikën e re të integritit urban, e cila do të fillojë me mbylljen e plotë të procesit të legalizimeve të shtëpive dhe me hapjen e një fondi të posaçëm për kanalizimet, ujësjellësit, rrugët, çerdhet, kopshtet, shkollat dhe gjithçka duhet, për t'i kthyer këto zona në njësi të reja të Tiranës evropiane.

8 Qershor 2009/Rama (Takim ne Kruje dhe Fushe Kruje)

“Ne angazhohemi solemnisht përpara jush se ajo kërkesë legjitime e kahershme dhe e refuzuar për vite me radhe me pashpirtësi dhe me cinizëm nga kjo politikë e vjetër në pushtet dhe nga ky kryeministër, që ka të bëjë me statusin e minatorit, do të merret nga ne parasysh dhe do të kthehet në realitet në 100 ditët e para të qeverisjes sonë.”

“Për kategorinë e atyre që nuk punojnë dot dhe nuk e kanë arritur moshën e pensionit, nuk do i japim më trajtimin e veçantë prej 6500 lekësh, por pensionin minimal. Domethënë, pensionin minimal që fillon nga të paktën 12 mijë lekë, (sigurisht të reja). Pensionin minimal të qytetit, 120mijë lekë, për secilin nga këta njerëz.”

Dhe angazhohem përpara jush që personalisht në emër të gjithë qeverisë sonë nesër, do t'i qëndrojmë mbi kokë për ditë çdo koncesionari, çdo sipërmarrësi që ka një kontratë me shtetin për shfrytëzimin e minierave dhe do të kërkojmë kushte të standardeve evropiane, mbi dhe nën tokë.”

Rama ka folur edhe për pensionet që do t'u lidhen fëmijëve të minatorëve dhe dhënien fund të trajtimit të tyre nga koncesionarët pa kushte pune.”

11 Qershor 2009/Ruci (Takim ne Fier)

“Berisha vonoi 2 vjet autostradën e Lushnjës, nuk vuri asnjë gur për unazën e Fierit, pengoi 4 vjet autostradën Levan- Tepelenë dhe vjen këtu me një sfond mbrapa, ku shikohen ca këmba ure, që ngrihen në Has të Kukësit dhe kërkon votat e fierakëve.

Partia Socialiste në pushtet, jo vetëm që do ta përfundojë atë rrugë, por do të nxjerrë njëkohësisht përgjegjësitë për rreth 250 milion euro që janë shpërdoruar në këtë rrugë, sipas konkluzioneve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.”

14 Qershor 2009/Rama (Takim ne zonat informale te Tiranës)

Ne do të ndërtojmë një politikë të re për rrethinat, do të ngremë një komitet shtetëror për zhvillimin e rrethinave, në rang ministrie, që do ta shoh këtë pjesë të komunitetit tonë dhe do t'i shoh të gjitha rrethinat e ndërtuara, me mundin e të ardhurave nga zonat e varfra të Shqipërisë, jo vetëm rreth Tiranës, por edhe Durrësit dhe qyteteve të tjera, jo vetëm si një proces legalizimi, sepse ky është vetëm hap i parë, por edhe si një proces integrimi urban. Ne do të ngremë edhe një fond të veçantë për të transformuar infrastrukturën e këtyre zonave, jo vetëm infrastrukturën fizike, që ka të bëjë me rrugët, kanalizimet, ujësjellësat, por edhe me infrastrukturën sociale, si çerdhet, kopshtet, shkollat, madje edhe hapësirat e përbashkëta sportive e kulturore. Ky nuk është një premtime, ky është një angazhim, nuk ka asnjë rrugë tjetër, përveç rrugës së realizimit të të gjitha këtyre pasurive.”

16 Qershor 2009/Rama (Takim ne Burrel)

Në angazhohemi për një politikë të re që do të rimëkëmbë arsimin, ku librat e shkollës do t'i japim falas për çdo fëmijë të varfër. Duke iu thënë të gjithëve që mes së shkuarës dhe të ardhmës, të zgjedhim të ardhmen, se ndryshimi që na duhet, është një ndryshim i madh, se transformimi që duam t'i japim Shqipërisë, është një transformim kolosal.

22 Qershor 2009/Rama (Takim ne Sauk dhe Shkoze)

E para, për legalizimet, ne do t'i kryejmë brenda mandatit tonë të parë dhe do t'i japim fund ankthit të të gjithë atyre njerëzve të ardhur apo që janë këtu prej kohësh, të cilët kanë ndërtuar me gjak një strehë për familjen e tyre të varfër.

E dyta, do t'i japim fund etjes së Tiranës dhe do të kemi 24 orë ujë në të gjithë Qarkun e Tiranës.

E treta do të bëjmë për Tiranën aq sa nuk kemi bërë në këto 8 vite, që në fakt kanë qenë 8 vite të një pune model dhe të një transformimi që e ia ka zili e gjithë Shqipëria. Do ta spostojmë modelin e Tiranës në të gjithë Shqipërinë dhe për Tiranën do të bëjmë shumë më tepër.”

23 Qershor 2009/Rama (Takim ne Durres)

Ne do t'i ndërtojmë fabrikat, ne do t'i ndërtojmë TEC-et. Ne do t'i ndërtojmë të gjitha ato që duhen për të zhvilluar industrinë e për të rritur ekonominë, por asnjë rast kjo nuk do të bëhet jashtë standardeve europiane dhe jashtë cilësisë që garanton çdo investim i tillë në Europën e Bashkuar.”

26 Qershor 2009/Rama (Mbyllja e fushatës Tirane)

Po unë vota atë ditë për Shqipërinë pa kufij në Evropën dhe një vit më vonë e kapërceva doganën greke pa vizë për të shkuar te im vëlla emigrant apo hyra në Itali pa vizë për të parë vajzën time studente.

Po, unë votova atë ditë për një Shqipëri me libra për të gjithë fëmijët, e me respekt për të gjithë mësuesit dhe pas një viti nuk pati më në Shqipëri as fëmijë të varfër që mbeteshin pa shkollë sepse nuk blinin dot librat, as mësues që mbeteshin pa bukë, sepse nuk bëheshin dot me pushtetin.

Po unë votova atë ditë për një Shqipëri ku mbi 50% e nënave të reja të mos mbeteshin më pa përfituar nga barrë lindja për shkak të varfërisë dhe nuk kaloi viti dhe cdo nënë që sjell në shtëpi gëzimin e lindjes së një fëmije, është e mbuluar me përfitimin nga barrë lindja pavarësisht nëse është familja e saj, e pasur apo e varfër, në qytet apo në fshat.

Po unë vota në 28 qershor 2009 për një Shqipëri ku 40 % e popullsisë, të mos mbeteshin më jashtë shërbimit shëndetësor dhe në 2011 u themelua shërbimi shëndetësor kombëtar, për çdo shqiptarë e shqiptare, ndërsa në

spitale nuk shkohet më me batanije dhe ilaçe me vete, kurse mjekëve dhe infermierëve u është rikthyer dinjiteti dhe qetësia.

Po, unë vota atë ditë për Shqipërinë me ujë të pijshëm për të gjithë që kemi sot, për Shqipërinë pa plehra, e dhera nga të katërt anët që kemi sot. Për Shqipërinë ku fshati jeton denjësisht në titujt e vet të pronësisë dhe me prodhimin e tij siç jeton sot.

Unë vota më 28 qershor për një Shqipëri ku shteti të mos ishte më i pushtetarëve, por i qytetarëve dhe pasuritë tona të përbashkëta të mos ishin më plaçkë për qeveritarët, por burim mirëqenie për të gjithë shqiptarët.

Disa nga Linket e premtimeve PS 2009

<https://ps.al/te-reja/zhvillohet-konferenca-kombetare-e-bujqesise-e-ps>

<https://top-channel.tv/2009/05/28/ps-fushata-nis-te-studentet/>

<https://www.ps.al/te-reja/rama-propozimi-i-ps-leternjoftime-falas-per-te-gjithe-shtetasit-pa-pasaporte-deri-me-28-qershor>

<https://www.ps.al/te-reja/fjala-e-kryetarit-te-ps-edi-rama-sot-ne-manifestimin-e-madh-qytetar>

<https://top-channel.tv/2009/02/21/ministria-e-bujqesise-premtimet-e-rames-demagogji/>

LSI 2009

Burimet e informacionit nga media online dhe deklaratimet publike të lidhshme të partisë në fushatën elektorale

10 Janar 2009/Ilir Meta mbledhje e KDK

Thelbi i programit tonë është rritja e mirëqenies për çdo qytetar shqiptar, e cila nis në radhë të parë nga lufta me program konkret kundër varfërisë dhe kundër monopoleve

në programin tonë në luftën kundër varfërisë, e cila prek në mënyrë tepër të rëndë dhe stresante gati 1/3 e shqiptarëve sot, pra në themel të këtij programi të luftës kundër varfërisë do të jenë bonusi jetik dhe punësimi jetik.

LSI në reformën e asistencës sociale do të institucionalizojë modelin e “punësimit jetik”, i cili kushtëzon përfundimin e ndihmës ekonomike kryesisht me punësimin në sektorin publik dhe sferën komunitare. Ky model do të përfshijë punësimin në shërbimet komunitare, si ato të mjedisit dhe ambientit, në shërbimet publike që lidhen me qendrat spitalore, rehabilituese, azileve të moshës së tretë, në mënyrë që edhe rritja e ndihmës ekonomike nëpërmjet punësimit jetik të individëve në nevojë të jetë në funksion të reduktimit të varfërisë, kohezionit social, si dhe të gëzojë një kompromis të gjerë social të taksapaguesve.

22 Janar 2009/Haxhinasto conference shtypi

Punësimi, si një objektivi madhor i programit të LSI. Ne kemi qellimin e punësimit të plotë të shqiptarëve brenda mandatit të ardhshëm

Lufta kundër varfërisë: ne do të propozojmë paketën e **bonusit jetik**, një paketë parashe në kesh, incentivash fiskale, dhe politikash të tjera për të mbushur hendekun e madh që ekziston midis nivelit me të ulët të të ardhurave dhe minimumit jetik – pra atë të të ardhurave minimale që marrin sot 1 në çdo 5 shqiptarë

Garantimi i jetes se qytetarit, që do të përmbajë në teresinë e politikave dhe masave për të rritur sigurinë e jetes se qytetarëve, në kushtet kur jeta e tyre është krejt e pasigurt. Këtu përfshihen gjithë masat dhe politikat që rrisin sigurinë e jetes se qytetarëve, duke filluar me **shëndetin, sigurinë ushqimore, mjedisin, dhe sigurinë fizike**.

25 Janar 2009/Ilir Meta takim në Berat

ne do ta çlirojmë Shqipërinë nga monopoli i Sali Berishës apo të kujtojmë tjetër, sepse ky duhet të jetë një vend që ofron mundësi për mirëqenie dhe mundësi për të gjithë shqiptarët, dhe jo vetëm për një pakicë që është e lidhur dhe mbrohet nga Sali Berisha.

27 Janar 2009/ Petrit Vasili conference shtypi

LSI denoncon publikisht edhe veprimin më të fundit të mazhorancës që rrëzoi e mbështetur edhe nga deputetë të PS, Projektligjin e paraqitur nga LSI për Statusin e minorit, duke dëshmuar qartë se të gjithë përbetimet dhe qarjet e qeveritarëve në familjet e minoritëve në raste të fatkeqësive të ndodhura, janë një hipokrizi e pastër

27 janar 2009/Prezantimi i platformës për bujqësinë

Krijimi dhe zhvillimi i tregut të tokës për ne është abc-ja e zhvillimit të këtij sektori. Ne do të konsolidojmë pronësinë mbi tokën dhe të zgjerojmë tregun e saj.

Zgjidhja e çështjes së pronësisë do të çlirojë në qarkullimin ekonomik edhe miliardë euro, tashmë të ngrira.

Modeli ynë subvencionues nuk do të jetë as fiktiv e as klientelist. Ai do të jetë një ndryshim thelbësor të subvencionimit, duke aplikuar subvencionimin për njësi produkti, pra subvencione për çdo kg mish, grurë, fruta apo litër qumësht të prodhuar.

Synimi ynë kryesor do të jetë krijimi i markave e brandeve që do të konkurojnë nesër në tregun e eksporteve, por edhe që do të furnizojnë në mënyrë atraktive industrinë turistike në vend.

Stimujt fiskalë do të përqendrohen në mënyrë të veçantë tek agro-përpunimi, hallka më e lënë pas dore e zinxhirit agro-industrial sot, ku do të jepen garancitë për kreditim dhe paketa stimujsh fiskalë.

Këto stimuj do të përjashtojnë nga tatimi mbi fitimin për tre vitet e para çdo biznes agro-përpunues.

Do të ketë një fond të veçantë për garanci kreditimi, si dhe do të ketë zbritje të konsiderueshme nga tatimi për bizneset agro-përpunuese për punësimin.

Punësimi, prioriteti ynë i parë, do të motivohet me skema incentivash konkrete fiskale.

Bonusi jetik dhe punësimi jetik do të jenë pjesë themelore e politikës sonë edhe në fshat, pasi aty është edhe varfëria më e madhe.

Investimi në kualifikimin profesional të rinjve dhe fermerëve në fushën e bujqësisë do të jetë prioritet i ynë, duke nxitur shkollat tekniko-profesionale.

30 Janar 2009/ Meta takim me anëtarësinë e Tiranës

LSI ka paraqitur prej një viti ne Kuvend projektligjin për kujdesin ndaj moshës së tretë, një projektligj i standardeve europiane që i ofron moshës së tretë në vendin tonë shërbime sociale të garantuara nga ligji.

Është po kjo qeveri, e cila në mënyrën më të padrejtë ka mohuar “Statusin e Ushtarikut”, të cilin kur ishte në opozitë e votoi dhe kur erdhi në pushtet e anulloi. Dhe, jo vetëm kaq, por kundërshton vendimin e Gjykatës Kushtetuese që një të gjitha të drejtat që u takojnë nga ligji që ka miratuar parlamenti në vitin 2005 “Për statusin e ushtarikut”.

Por, do të punojmë që ky ligj pas fitores në 28 qershor të zbatohet sepse ky është një detyrim për ata njerëz që kanë sakfrikuar për dekada të tëra në shërbim të atdheut.

Lëvizjes Socialiste për Integrim jo vetëm që ka bashkëpunuar me ta, jo vetëm që morri përsipër të propozojë Statusin e Minatorit, por dëshiron të shprehë edhe një herë tjetër vendosmërinë e saj për bashkëpunuar në mënyrë që Parlamenti i Shqipërisë dhe qeverisja e ardhshme të vlerësojë kontributet dhe sakrificat e këtyre njerëzve

6 Shkurt 2009/HAXhinasto në conference shtypi

Per LSI zgjidhja dhe konsolidimi i çështjes se pronesise ne Shqiperi eshte prioritet i programit te saj qeverises, pasi zgjidhja e saj eshte jo vetem çështje e te drejtave themelore te qytetareve, por edhe percaktuesi kryesor i zhvillimit te qendrueshem vendit.

8 Shkurt/Illir Meta në Kukës

Durres-Kukes/

Në këtë drejtim unë dua t’ju siguroj se me këto ritme duket që rruga nuk i ka mundësitë të përfundojë para zgjedhjeve, sikur është premtuar. Por ne pas fitores do ta përfundojmë dhe do ta inagurojmë të gjithë së bashku, sepse është rrugë e të gjithë shqiptarëve.

9 Shkurt 2009/ Meta conference shtypi

Nepermjet ketij projekt-ligji propozojme nje pension te 13-te per cdo person te moshes se trete

Propozojme ngritje te institucioneve te kujdesit per moshen e trete nga pushteti vendor ne gjithe vendin

Propozojme rimbursim te plote te cdo medikamenti qe perdor moshja e trete

Propozojme transport urban falas apo me gjysem cmimi. Propozojme shërbim shëndetësor ne familje falas.

Propozojme strehim me priiritet per moshen e trete
Propozojme nje pagese minimale per pensionistet qe jetojne ne shtepi me te paafte te tjere

Keto sherbime qe propozon project-ligji i LSI per moshen e trete kane nje fature fiannciare qe nuk e kalon 70 milion dollare ne vit

Rimbursimi i plote i ilaceve kushton rreth 25 milion dollare ne vit

Pensioni suplementar, mbi gjelin e detit qe jepet nga qeveria cdo vit, kushton 26.6 milion dollare

Te gjitha sherbimet e tjera qe parashikon ligji nuk e kalojne 20 milion dollare

13 Shkurt 2009/ Meta takim ne Durres

Kjo do te thote qe te krijohen lehtesia fiskale per bizneset e reja prodhuese, te cilat duhet te krijohen dhe te stimulohen

Qeveria te ndermarrin politika reale dhe jo fiktive te formimit profesional

Do te subvencionojme prodhimin bujqesor jo ne menyre demagogjike dhe korruptive, siç ndodh sot, ne menyre krejtësisht klienteliste dhe partiake, por ne menyre konkrete dhe efikase

Do te subvencionojme per çdo liter qumësht qe do te prodhohet, per çdo kilogram grurë qe do te prodhohet, per çdo kilogram fruta qe do te prodhohet, ne menyre qe shqiptaret ti kthehen punes ne bujqesi

Do te ndërtojmë dhe do te realizojmë një politikë, e cila mungon sot, per zhvillimin e industrisë agro përpunuese
20 mijë vende pune mund te hapen per te gjithë ata te rinj apo te gjithë ata shqiptarë qe do te dëshironin te punësoheshin ne transportin detar

16 Shkurt 2009/ Meta takim ne Kamez

Ne nuk premtojmë çekun e bardhë, por ne premtojmë punësim per çdo familjar qe ka nevojë per te punuar per te siguruar te ardhura

Ne garantojmë rritjen e punësimit si prioritetin numër një te qeverisjes së ardhshme

Ne garantojmë legalizimin per t'i dhënë fund kësaj drame qe keni ju qe keni gati dy dekada

18 Shkurt 2009/ Ilir Meta inspekon Durres-Kukes

ne angazhohemi qe ne rast se kjo rrugë nuk përfundon deri ne 28 Qershor, dhe ne dëshirojmë te përfundojë, jemi këtu te shprehim angazhimin tonë qe kjo rrugë ne qeverisjen e ardhshme te përfundojë sa më shpejt, sepse i gjithë ky investim, i gjithë ky shfrytëzim qe është bërë duhet te kthehet ne mirëqenie per te gjithë shqiptarët dhe Ballkanin.

20 Shkurt 2009/ Ilir Meta ne Vlore

do te jetë përgjegjësia, nderi dhe privilegji ynë te përfundojë edhe rrugën e Kosovës edhe rrugën e bregdetit jam i bindur se një nga vendimet e para te mazhorancës sonë fituese pasi te nxjerrim ne pension te përhershëm politik Sali Berishën ne 28 Qershor do te jetë heqja e një vendimi diskriminues per vlonjatët, per durrsakët, sarandiotët dhe per te gjithë shqiptarët, qe është ai i kufizimit te mjeteve te lundrimit vetëm per shqiptarët

21 Shkurt 2009/ Ilir Meta programi per shendetesine

Garantimi i nje sherbimi mjeksor gjithnje e me prane qytetareve duke siguruar funksionimin e qendrave shendetsore edhe ne fshatrat me te largeta dhe mbulimin me personel mjeksor te tyre.

Krijimi i nje urgjence kombetare te arritshme nga çdo qytetar dhe me teknologjine e duhur per te dhene sherbimin e nevojshem per pacientin.

Rritje e menjehershme e financimit te shendetsise ne PBB deri ne minimumi 4% ne fund te mandatit qeverises, per te garantuar investime te qendrueshme ne shendetesi, qe u sigurojne qytetareve nje sherbim mjeksor cilesor dhe qe nuk i detyron ata te shpenzojne parate e tyre ne spitalet jashte vendit duke renduar varferine e familjeve te tyre.

Ndertimi i nje skeme te sigurimeve shendetsore reale qe garanton e mbulon plotesisht qytetaret per sherbimin paresor te tyre qe nga vizita mjeksore, ekzaminimet e deri tek lista e plote e barnave qe rimbursohen si dhe mbulimit prej sa te nje sherbimi spitalor cilesor dhe te ndershem.

Realizimi i rajonalizimit të spitaleve në nivel të çdo qarku duke standartizuar veprimtarinë, personelin shëndetësor të nevojshëm, infrastrukturën dhe teknologjinë mjeksore përkatëse për të ofruar një kujdes spitalor të kualifikuar sa më pranë qytetarit pa pasur nevojë që të atë të vijne në Tiranë apo të shkojnë jashtë shtetit për probleme që mund të zgjidhen në spitalin rajonal.

Ndryshimi rrenjesor i spitaleve tona duke nxitur e mbështetur autonominë e tyre dhe sigurimi i një shërbimi mjeksor spitalor me cilësi ku pacientet nuk janë të detyruar të as blejnë barna dhe as të paguajnë nën dorë mjekët për nderhyrjet mjeksore të nevojshme për shërimin e tyre.

Sigurimi i një kontrolli sanitar dhe epidemiologjik intensiv, profesional dhe të mbështetur me kompetencat ligjore të duhura për të garantuar ujë të pijshëm të sigurtë, evitimin e rrezikut të epidemive, sigurinë e shëndetit në punë dhe në shkollë, ushqime të sigurtë dhe mjedise urbane dhe ajër shëndetësisht të pademshëm.

Sigurimi i shërbimit mjeksor të specializuar për të moshuarit në të gjithë spitalet e vendit

24 Shkurt 2009/ Meta takime në Korce dhe Pogradec

Meta u shpreh se punësimi jetik do të jetë një ndër prioritetet kryesore të programit qeverisës të LSI, në mënyrë që çdo familje të ketë një të punësuar.

Kjo do të realizohet përmes rritjes së investimeve publike dhe disa incentivave konkrete fiskale, lehtësuese për bizneset.

27 Shkurt 2009/ Meta takim në Fier

Angazhimi ynë solemn përpara gjithë të rinjve dhe përpara gjithë shqiptarëve është, punësim për të gjithë shqiptarët që dëshirojnë të sigurojnë një vend pune brenda katër viteve të ardhshme. Dhe kjo është krejtësisht e realizueshme me Lëvizjen Socialiste për Integrim.

angazhohemi të përmirësojmë në mënyrë të ndjeshme raportin midis shkollës së mesme profesionale dhe shkollës së përgjithshme.

Në do të punojmë për të krijuar filiale të universiteteve në qytetet më të rëndësishme

Në do të punojmë që rinia të ketë sa më shumë ambiente sportive

6 Mars 2009/ Meta fjalë në Konventën e grave

Në do ta fëvorizojmë me lehtësira fiskale, në veçanti, bizneset që punësojnë gra e sidomos ato që punësojnë kryefamiljare.

Në do të mbështesim konkretisht gratë që synojnë të hapin biznese, sepse unë besoj të shpirti sipërmarrës i gravë sepse, në fund të fundit, çdo grua është një administratore qoftë dhe e atyre punëve dhe problemeve të shtëpisë.

Të gjitha gratë kryefamiljare do të marrin ndihmë ekonomike të plotë dhe do të ketë një politikë të veçantë nga ana e qeverisë dhe e shtetit për to.

Do të aplikojmë një sistem totalisht të ri të kontrollit shëndetësor duke ofruar shërbime falas për gratë, për vaksinimin dhe patologjitë specifike që prekin ato.

7 Mars 2009/ Meta programi për arsimin

Paga e mësuesit do të dyfishohet brenda mandatit të ardhshëm qeverisës

Brenda 4 viteve të ardhshme do të ristrukturojmë mbi 80 përqind infrastrukturën e shkollave

Brenda 4 viteve të ardhshme do të realizojmë decentralizimin e plotë të shkollës me qëllim rritjen e efektivitetit të saj

Qeverisja jonë do të vendosë një partneritet solid midis sektori publik dhe atij privat të arsimit

Heqja e menjëhershme e TVSH nga shërbimet e arsimit, si dhe ulja e detyrimeve të tjera, duke përfshirë edhe tatimin mbi fitimin

Diplomat e studentëve që përfundojnë arsimin e lartë, të duhet të jenë në përputhje me kategoritë dhe mundësitë e punës

Kërkimi shkencor është një prioritet shumë i rëndësishëm

Arsimimi i çdo fëmije është një e drejtë e tyre dhe një detyrim i shtetit

Minimalizimi i braktisjes së shkollës duke ndryshuar ligjin ekzistues me synimin për t'i dhënë përparësi masave parandaluese në këtë drejtim dhe jo thjeshtë atyre ndëshkimore

Ne do t'i kthejmë shkollat në qendra të integruara për shërbime komunitare
Paketa jone e Bonusit jetik parashikon subvencionimin e plotë të librave për familjet e varfra, një masë që do ndikojë në zbutjen e braktisjes së shkollës.

Do të krijojmë mundësi për kreditimin e studimeve universitare nga bankat, pa interes, për ata studentë që kanë nevojë.

Mësimi i gjuhës shqipe nga emigrantët do të jetë pjesë e rëndësishme e reformës sonë arsimore

9 Mars 2009/Dritan Prifti konference per shtyp

Qëndrimi i LSI është totalisht kundër këtij privatizimi, kundër mënyrës se këtij privatizimi dhe ne po e deklarojmë zyrtarisht që nuk do ta pranojmë këtë privatizim dhe menjëherë pas zgjedhjeve, me ardhjen tonë në Qeveri, ky do të jetë një nga privatizimet që do të rishikohet menjëherë prej nesh

10 Mars 2009/Meta me ish ushtaraket

pas 28 Qershorit, kur Berisha pa diskutim që do të shkojë në opozitë dhe do të dalë në pension, pa diskutim që do të zbatohet vendim nr.9 i Gjykatës Kushtetuese i vitit 2007. Pra, do të zbatohet ligji i miratuar në vitin 2005. Është një detyrim jo vetëm kushtetues, por është një detyrim politik, një detyrim social e njerëzor, dhe një detyrim atdhetar i secilit prej nesh që është angazhuar në politikë, për arsye të atdhetarizmit dhe sakrificave që përfaqësojnë ish-ushtaraket përgjatë gjithë jetës së tyre.

24 Mars 2009/ Meta takim me jetimet

Në themel të gjithë angazhimit tonë të ardhshëm dhe qeverisë do të jetë punësimi dhe punësimi për jetimet do të jetë një prioritet i jashtëzakonshëm, pasi është e tmerrshme të shikosh që njerëz që kanë qenë jetim që të vegjël, të cilët edhe pasi kanë mbaruar shkollën e mesme ndihen jo vetëm jetimë, por edhe të papunë, të paintegruar, të braktisur.

26 Mars 2009/Meta takim me ish punonjes te administrates

Do të rrisim optimizimin e njerëzve më të përgatitur të këtij vendi për të shërbyer në administratën publike, që do të thotë se ne do të synojmë që pagat në administratën publike të jenë plotësisht të konkurrenceshme me ato në sektorin privat.

Ata të punojnë në administratë publike, sikurse do të jetë kreditimi në interesa shumë të favorshëm, për problemin e strehimit

27 Mars 2009/Meta takim ne Cerrik

Kryetari i LSI ka ofruar mbeshtetjen edhe per industrine dhe bujqesine vendase. Meta shtoi se nepermjet programit te LSI do te mund te hapen 30 mije vende te reja pune.

28 Mars 2009/Meta ne Peqin dhe Belsh

Kemi nje plan te qarte qe permes krijimit dhe zhvillimit te industrise agroperpunuese, ne 4 vitet e ardhshme te krijojme 30 mije vende te reja pune ne te gjithe Shqiperine

28 Mars 2009/Meta takon bizneset fason

Koha për Veprim, që të ndihmojmë këta biznese që punësojnë mijëra shqiptarë. Të garantohen lehtësira fiskale për këtë industri

Qeveria të subvencionojë sigurimet shoqërore për punonjësit. Të bëhet në kohë rimbursimi i tvsh.

Qeveria dhe Banka të mundësojnë ristrukturimin e kredive për bizneset fason

31 Mars 2009/Meta takim me minatorët

Meta garanton minatorët për miratimin e statusit të minatorit dhe uljen e moshës së pensionit pas fitores së LSI në 28 Qershor

Meta shprehet se ndërtimi i rrugës së Arbrit është një domosdoshmëri

6 Prill 2009/Meta takim ne Krutje

Bujqësia do të dalë nga kjo krizë e rëndë në të cilën ndodhet, vetëm duke zbatuar planin tonë, për të forcuar rolin e shtetit dhe qeverisë me një program të qartë, i cili fillon që nga garancitë për sigurinë e farërave dhe inputeve të tjera që shpesh skadojnë dhe deri tek subvencionimi për farërat, për plehun kimik, për punimin e tokës, për mekanizmat bujqësore e deri tek subvencionimi i të gjithë prodhimit

9 Prill 2009/Meta takim elektoral Vlore

Une dhe bashkepunetoret e mi kemi nje plan real, te mirestudiuar dhe konkret per krijimin e 100.000 vende te reja pune, ne te gjithë sektoret e vecanerisht ata qe lidhen me agro-industrine e agro-turizmin.

Dhe ketu ne Vlore ne do te bejme shume pune, duke filluar nga perfundimi i rruges se Bregut qe kjo qeveri e paafte nuk e ka cuar vec pak kilometra me tutje e qe do ti jap nje shtytje te madhe turizmit ne keto vende te bukurise se rralle.

10 Prill 2009/Meta takim me gjimnazistet

LSI angazhohet per nje rikonceptim te reformes se Matures Shteterore

13 Prill 2009/Meta takime ne Korce

LSI do të zbatojë politika mbështetëse dhe subvencionuese nga shteti, që nga farërat, plehurat kimike, punimi i tokës, investimet për makineri bujqësore, subvencionimi për njësi prodhimi

19 Prill 2009/ Meta ne Kamze

ka nevojë dhe për të bërë rrugën e “Arbrit”, për të bashkuar Tiranën me Bulqizën

Pra për çdo biznes të ri që do punësojë më shumë sesa pesë veta ne do të heqim tatim fitimin për disa vite.

21 Prill 2009/Meta ne Laprake

unë dua t'ju siguroj që ne kemi një plan të qartë konkret dhe të efektshëm për ti ardhur në ndihmë kësaj kategorie. Në këtë drejtim ne do të rishikojmë politikën e taksave për të ardhurat e individit, duke përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat të gjitha pagat deri në 25 mijë lekë të reja në muaj

27 Prill 2009/Meta ne Vlore

Subvencionimi i inputeve bujqësore në masën 25 për qind, për të vazhduar me subvencionimin e prodhimeve përmes parimit “kush prodhon më shumë, të subvencionohet më shumë

Synohet që deri në vitin 2010 të dyfishohen investimet për bujqësinë duke krijuar perspektivë si dhe duke siguruar projekte afatgjatë që do të ndryshojë edhe raportin e importeve dhe eksporteve të produkteve bujqësore, duke synuar rritjen e prodhimit të vendit dhe si rrjedhojë rritjen e eksporteve.

28 Prill 2009/Meta takim me peshkataret

Do të ndërtojmë një flotë të re peshkimi, që të jetë shumë agresive për të rritur kapacitetet e peshkimit, për të shfrytëzuar këto resurse të jashtëzakonshme, që i ka dhuruar natyra vendit tonë

29 Prill 2009/Meta takim ne furre buke Tirane

LSI-ja ka një plan për të ulur koston e jetesës, sidomos për produktet bazë, për produktet e shportës dhe një nga masat që ne do të marrim është përgjysmimi i TVSH-së për këto produkte nga 20% në 10 %, në mënyrë që të ndihmojmë në uljen e çmimeve

30 Prill 2009/Meta firmos me partine e te drejtave te emigranteve

LSI ka insistuar gjithnjë për të drejtën e votës së emigrantëve, aty ku ata punojnë dhe banojnë

Do të bëjmë gjithçka për të njohur të gjitha sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe të gjitha llojet e tjera të sigurimeve të vëllezërve e motrave tanë emigrantë

Do të favorizojmë investimet e emigrantëve në Shqipëri

1 Maj 2009/ Meta konference per shtyp

Plani i LSI për të përkrahur biznesin e fasonëve konsiston në subvencionimin në masën 50 %, të sigurimeve shoqërore për punëdhënësit deri në dhjetor të vitit 2011 dhe njëkohësisht për heqjen e tatimit-fitimit për këto biznese, deri në dhjetor të vitit 2010

7 Maj 2009/ LSI marreveshje me partine e romeve

Do të garantojmë strehim, punësim dhe arsim për komunitetin rom dhe atë egjiptian

8 Maj 2009/ LSI takim ne Pogradec

Ne kemi të qartë programin tonë për hapjen e 100 mijë vendeve të reja pune për shqiptarët në katër vitet e ardhshme

9 Maj 2009/ Meta takim me shoqaten fasonë

Propozimet tona kanë të bëjnë me heqjen e tatimit mbi fitimin deri në Dhjetor të vitit 2010, subvencionimin e sigurimeve shoqërore në masën 50 për qind deri në fund të vitit 2011, dhe subvencionimin 100 për qind të sigurimeve shoqërore për çdo vend të ri pune që do të krijohen në këtë periudhë krize

10 Maj 2009/ Prifti takim me ish-punonjes te ARMO-s

LSI do të hapë 6 mijë vende të reja pune, në sektorin e naftës

LSI garanton statusin e naftëtarit, dhe pagesën e plotë për ish-punonjësit e ARMO-s, që kjo Qeveri e paaftë i ka nxjerrë në rrugë

12 Maj 2009/ Meta prezanton Planin e Veprimit

Në themel të këtij “Plani për Veprim” qëndron pikërisht punësimi si shtylla kryesore dhe objektivi kryesor mbi të cilin do të ndërtohet mirëqenia e qytetarëve shqiptarë dhe në radhë të parë e atyre që janë papunë. Të gjitha politikat tona qeverisëse, zhvillimore dhe arsimore janë në funksion të punësimit, të krijimit të vendeve të reja të punës dhe sikurse e kemi bërë të ditur prej kohësh, Plani ynë për Veprim dhe programi ynë elektoral dhe qeverisës ka një synim tepër realist, por edhe ambicioz për hapjen e 100 mijë vendeve të reja të qëndrueshme të punës gjatë katër viteve të ardhshme

15 Maj 2009/ Meta ne Durres

Do të ndërtojmë në Durrës, Portin më të fuqishëm në Ballkan

LSI do të realizojë heqjen e vizave brenda rajonit deri në fund të vitit 2009, dhe do të realizojë lëvizjen e lirë në BE brenda një vit

16 Maj 2009/ Meta ne Vlore

Karaburuni do të shëndërrrohet në perlën turistike të gjithë Mesdheut

17 Maj 2009/ Meta ne Elbasan

Do të përgjysmojmë TVSH për produktet ushqimore bazë, masë që do të ndikojë në uljen e çmimeve të produkteve të shportës

19 Maj 2009/ Meta ne minimarket ushqimor

Jemi të vendosur për të përgjysmuar nga 20 % në 10 % TVSH-në, për ushqimet bazë të shportës që do të thotë çmime më të liradhe më të pranueshme në treg

20 Maj 2009/ Meta takim me femijet jetime

Do të garantojmë strehim, arsimim dhe punësim për të gjithë fëmijët jetimë

21 Maj 2009/ Meta ne Shkoder dhe Puke

Do të subvencionojmë energjinë për 300 kilovat/ orë në muajpër konsumatorët familiarë të varfër dhe do të përgjysmojmë TVSH nga 20% deri në 10% për produktet e shportës, si vaji, orizi, makaronat etj

23 maj 2009/ Meta ne komunat e Fierit

Meta premtos statusin e naftëtarit, hapjen e 6 mijë vendeve të reja të punës në sektorin e naftës, duke mbrojtur dhe mjedisin për të mos dëmtuar banorët e kësaj zone

23 Maj 2009/ Pesha ne Vlore

LSI-ja do të shfuqizojë moratoriumin për mjetet e vogla lundruese

24 Maj 2009/ Meta ne Patos

Meta premtos statusin e naftëtarit dhe hapjen e 6 mijë vendeve të reja pune ne industrinë e naftës, duke ruajtur dhe mjedisin

25 Maj 2009/ Meta konference shtypi

Brenda një viti ne do të plotësojmë të gjitha standartet për liberalizimin e plotë të vizave mes Shqipërisë dhe BE-së

9 Qershor 2009/ Meta me banoret e Bathores

Jam i bindur se do kem mundësinë me votën tuaj për të zgjidhur njëherë e përgjithmonë çështjen e legalizimeve

10 Qershor 2009/ Meta takim ne Vlore

“Plani ynë për Veprim” është plani që ndihmon gati 1 milionshqiptarë që të kapërcejnë njëherë e mirë pragun e varfërisë

10 Qershor 2009/ Meta ne Lezhe

Ne do ta kthejmë Lezhën në një perlë të Adriatikut që të konkurojë me dinjitet edhe perlat e Adriatikut në Itali

12 Qershor 2009/ Meta takime ne Shkoder

Shqipëria ka mundësi të mëdha për t’u zhvilluar, por nuk do të zhvillohet me përralla si puna e centraleve bërthamore apo atyre termocentraleve që do Saliu të na i ndërtojë në Durrës dhe në vende të tjera turistike të vendit

14 Qershor 2009/ Meta takime ne Perrenjas dhe Peqin

Sot disa parti po kujtohen gjoja për statusin e minoritit, por dy vjet më parë ishte LSI ajo që paraqiti në parlament projektligjin për statusin e minoritit dhe ata që kërkojnë vota me statusin e minoritit e rrëzuan, por ne do ta miratojmë këtë projektligj

Link i premtimeve LSI 2009

<https://shqiptaria.com/lajm/kush-e-beson-lsi-ja-47-premtimet-e-pambajtura-ne-qeverisje-me-pd?r=kh14>

ALTAX

PREMTIMET ELEKTORALE

NË

ZGJEDHJET POLITIKE 2009



POLIFAKT

www.polifakt.al

www.altax.al